



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 244 Akti

Nr. 333 Vendimi
Tiranë, më 13.1.2021

V E N D I M

Trupi gjykues nr. 4 i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Roland Ilia	Kryesues
Valbona Sanxhaktari	Relatore
Genta Tafa (Bungo)	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Orjanda Liçi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Tonci Petkovic, në datën 11.1.2021, ora 12:30, zhvilloi në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Shkëlqim Mustafa, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë, i pranishëm në seancën dëgjimore.**

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet “A”, “Ç”, “D”, “DH”, “E” dhe “Ë” të Aneksit të Kushtetutës; Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.**

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Z. Shkëlqim Mustafa është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë. Bazuar në pikën 4, të nenit 4 dhe në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, si dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) ka hedhur shortin në datën 15.1.2019, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 4.

2. Me vendimin e trupit gjykues datë 18.1.2019 është vendosur kryesues komisionerin Roland Ilia dhe është deklaruar lidhur me konfliktin e interesit nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues.

3. Më tej, subjekti i rivlerësimit është njoftuar për përbërjen e trupit gjykues, i cili ka deklaruar se nuk ka konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.

4. Janë administruar raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ). Subjekti është kontaktuar nëpërmjet adresës elektronike, të deklaruar për hetim të mëtejshëm, ku iu dërgua pyetësori i përgatitur nga Komisioni, si dhe pyetje të tjera gjatë hetimit administrativ.

5. Në datën 19.10.2020, trupi gjykues vendosi: (i) të përfundojë hetimin kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Shkëlqim Mustafa, bazuar në të tria kriteret e vlerësimit: kriterin e vlerësimit të pasurisë, kriterin e kontrollit të figurës dhe atë të vlerësimit profesional; (ii) të njoftojë

subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit dhe barrën e provës, ta ftojë atë për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si edhe afatin brenda të cilit mund t'i ushtrojë këto të drejta dhe të paraqesë parashtrimet e saj.

6. Subjekti i rivlerësimit u njoh me dosjen dhe mori një kopje të saj, fakt të cilin edhe e konfirmoi. Subjekti paraqiti brenda afatit të përcaktuar shpjegime dhe prova lidhur me barrën e provës dhe rezultatet e hetimit të Komisionit.

7. Trupi gjykues ftoi subjektin e rivlerësimit, z. Shkëlqim Mustafa, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, në seancë dëgjimore, në datën 11.1.2021, ora 12:30, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

8. Seanca dëgjimore u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 11.1.2021, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Tonci Petkovic.

9. Në këtë seancë subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht dhe parashtrori qëndrimin e tij lidhur me rezultatet e hetimit. Në përfundim të seancës dëgjimore subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

10. Trupi gjykues përfundoi seancën dëgjimore dhe, për rrjedhojë, edhe procesin e rivlerësimit për z. Shkëlqim Mustafa në seancën e datës 13.1.2021, në të cilën subjekti ishte i pranishëm.

II. PROCESI I RIVLERËSIMIT I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

11. Procesi i rivlerësimit, i cili kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Anëtarët e Komisionit hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Ata kanë të drejtë të çmojnë sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo *indicie* në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes.

12. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi të pabazuar në përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse¹.

13. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja dhe provat e dorëzuara nga subjekti pranë këtij institucioni në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, *Vetting*;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga DSIK-ja, së bashku me dokumentacionin shoqërues;
- c) informacionin e përditësuar nga institucionet ligjzbatuese sipas përcaktimeve ligjore;
- ç) raportin e dorëzuar në Komision nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, së bashku me materialin shoqërues;
- d) dokumente shpresore të vëna në dispozicion nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- dh) deklaratimet e vëna në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet komunikimit elektronik;
- e) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, si dhe provat e paraqitura në përfundim të hetimit kryesisht;
- ë) denoncimet nga publiku.

A. VLERËSIMI I PASURISË

14. Subjekti i deklaratimit ka dorëzuar deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit në ILDKPKI së bashku me dokumentacionin provues. Në përfundim të hetimit administrativ, bazuar në germën "a", të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të

¹ Vendimi nr. 2/2017 i Gjykatës Kushtetuese, "41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit, është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: "Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit". Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë Komisioni i Pavarur i Kualifikimit gjatë këtij procesi."

gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja në raportin e saj ka konkluduar se:

- deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- nuk ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

15. Në deklaratën e pasurisë *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si vijon:

1. Truall me sipërfaqe 500 m², Rr. “**” Gjirokastër**, blerë me Kontratën e Shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.4.1998, në vlerën 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë likuiduar jashtë zyrës së noterisë, me shitës z. V. L. dhe blerës z. Shkëlqim Mustafa.

1.1 Subjekti deklaron se kjo pasuri është shitur me Kontratën e Shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.7.2006, në Gjirokastër, me blerës z. A. V.. Çmimi i shitjes së pasurisë është 1.000.000 (një milion) lekë të likuidura jashtë zyrës së noterisë, para datës së nënshkrimit të kontratës.

1.2 Subjekti i rivlerësimit deklaron si burim për pasurinë e mësipërme - kursimet e tij ndër vite.

1.3 Kjo pasuri është deklaruar në Deklarimin Fillestar në vitin 2003, si: *“Truall për ndërtim shtëpie (shesh ndërtimi) me sipërfaqe 500 m²”*. Në DPV-në e vitit 2006 subjekti deklaron shitjen e truallit në Rr. “****”, Gjirokastër, në vlerën 1.000.000 (një milion) lekë.

1.4 ZVRPP-ja² Gjirokastër ka konfirmuar se në emër të subjektit të rivlerësimit figuron e regjistruar me nr. hipotekor ***, datë 27.4.1998, pasuria me nr. ***, e llojit “truall”, me sipërfaqe 500 m², në Gjirokastër, e cila është përfituar me Kontratën e Shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.4.1998. Kjo pasuri është transkriptuar³ te z. A. V. V. sipas Kontratës së Shitjes me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.7.2006 sipas së cilës çmimi i shitjes prej 1.000.000 (një milion) lekësh është likuiduar jashtë zyrës së noterisë dhe përpara datës së nënshkrimit të kontratës.

1.5 Subjekti ka bashkëngjitur mandatarkëtimin nr. ***, datë 20.7.2006, me vlerë pagese 5.000 (pesë mijë) lekë (pagesa e tatimit përkatës), derdhur për llogari të Degës Rajonale Tatimore Gjirokastër, në arkat e ZRPP-së Gjirokastër. Sipas ligjit të kohës, Udhëzimi datë 18.1.2005, “Për tatimin mbi të ardhurat”, pika 2.7, subjekti ka kryer pagesën e plotë të detyrimeve tatimore⁴.

1.6 Komisioni vlerësoi të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit në vitet 1995 – 1998, të cilat rezultojnë se të ardhura kanë qenë vetëm paga e tij si prokuror dhe shpenzimet për dy persona. Nga analiza financiare, duke mbajtur në konsideratë vetëm shpenzimet jetike, rezulton se subjekti ka pasur mundësi financiare me burime të ligjshme për të krijuar pasurinë në vitin 1998 sipas deklarimit në vlerën 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

1.7 Në përfundim, Komisioni ka konstatuar se çmimi i shitjes së kësaj pasurie në vitin 2006 është 600 % më i lartë se ai i blerjes. Duket se veprimet për blerjen apo shitjen e kësaj pasurie i janë referuar çmimeve fiktive. Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të shpjegojë bindshëm lidhur me këtë rezultat.

1.8 Në vijim, subjekti ka shpjeguar se: *“... shitjen e këtij trualli e kam kryer në bazë të një çmimi prej 2.000 lekësh/m². Parë nën këtë këndvështrim, çmimi është real dhe i vërtetë, disa herë më i ulët sesa çmimi i sotëm i aplikuar në Gjirokastër. Kjo për faktin se faktori kohë dhe në këndvështrim të etapave të caktuara, luan një rol të rëndësishëm në rritjen apo uljen e çmimeve të mallrave apo shërbimeve të caktuara, varësisht nga nevojat e njerëzve. Ky konkluzion është gjerësisht i pranishëm në rastet tona gjyqësore, pavarësisht nga rrethi gjyqësor ku konstatohet, si dhe është i rëndësishëm për të dhënë një vlerësim të drejtë të pasurisë së paluajtshme.”*

² Shihni shkresën nr. *** prot., datë 24.10.2016 nga ZVRPP-ja Gjirokastër (dosja ILDKPKI, Aneks 4/2) dhe shkresën me nr. ***prot., datë 23.4.2018 (dosja ILDKPKI, Aneks 28). Vërtetimi nga Dokumentet Hipotekore, datë 27.4.1998, në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe Kontrata e Shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.4.1998, e nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit, i cili i ka blerë shtetasit V. L. pasurinë “truall”, kundrejt shumës 150.000 lekë.

³ Vërtetimi nga dokumentet hipotekore, datë 25.7.2006, në pronësi të shtetasit A. V. V.; Kontrata e Shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.7.2006, e nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit, i cili i ka shitur shtetasit A. V. truallin me sip. 500 m², me çmim 1.000.000 lekë të likuiduara jashtë zyrës noteriale.

⁴ Kalimi i të drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme, tatohet sipas pasqyrës nr. 2 bashkëlidhur këtij Udhëzimi”. Subjekti vazhdon duke sqaruar se në këtë pasqyrë (nr. 2) përcaktohet edhe vlera e tatimit, e cila për pasuritë me vlerë shitje nga 0-2.000.000 lekë llogaritet 0.5% e çmimit të shitjes.

1.9 Në përfundim, Komisioni vlerësoi shpjegimet e subjektit, si dhe faktet që lidhen me shitjen e kësaj pasurie dhe arrin në konkluzionin se pavarësisht se vlera e shitjes së kësaj pasurie ishte disa herë më e lartë se çmimi i blerjes së saj, çmimi i shitjes ishte i logjikshëm dhe i pranueshëm referuar vlerave të tregut të shitjes së trojeve në vitin 2006.

2. Apartament banimi me sipërfaqe 88.8 m², Gjirokastrë, blerës z. E. M. F. (vjehtëri i subjektit), me Kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.9.2006, në shumën prej 3.700.000 (tre milionë e shtatëqind mijë) lekësh, likuiduar jashtë zyrës së noterisë.

2.1 Subjekti i rivlerësimit deklaroi si burim për blerjen e apartamentit në vitin 2006: (i) të ardhurat e krijuara nga shitja e truallit (pasuria nr. 1 më sipër); (ii) kredi në vlerën 3.000.000 (tre milionë) lekë, marrë tek “Alpha Bank”, në datën 18.10.2006.

2.2 Subjekti deklaroi shitjen e apartamentit nëpërmjet Kontratës së Shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.8.2010, shtetasve E. dhe L. H., në vlerën 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) euro.

2.3 Subjekti ka paraqitur një dokument nga ASHK-ja⁵ Gjirokastrë, ku konfirmohet pagesa e detyrimit financiar në vlerën 441.800 (katërqind e dyzet e një mijë e tetëqind) lekë, datë 26.8.2010, e cila sipas Udhëzimit nr. 5, datë 20.1.2006, i ndryshuar, rezultoi 10 % e diferencës së çmimit të shitjes me atë të blerjes ose e thënë në vlerë absolute për pronën e subjektit në vlerë 441.800 lekë.

2.4 ZVRPP-ja Gjirokastrë⁶ konfirmon pasurinë me nr. ***, regjistruar me nr. hipotekor ***, datë 6.9.2006, pasuri e llojit “apartament banimi”, ndodhur në lagjen “****”, Gjirokastrë, me pronar z. Shkëlqim Mustafa, përfutur me Kontratë Shitje me Rezervë me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.9.2006, nga shtetasi E. M. F. (vjehtëri i subjektit). Sipas kontratës së shitjes, çmimi i blerjes është 3.700.000 (tre milionë e shtatëqind mijë) lekë, i paguar me dy këste, 700.000 (shtatëqind mijë) lekë në datën e përpilimit të kontratës dhe 3.000.000 (tre milionë) lekë në datën e lëvrimit të kredisë nga “Alpha Bank”, të cilat janë transferuar në llogarinë bankare të shtetasit E. F..

2.5 Me Kontratën e Shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.8.2010, pasuria nr. ***, iu shit shtetasve E. dhe L. H., duke u regjistruar me nr. hipotekor ***, datë 1.10.2010. Referuar kontratës, çmimi i shitjes është 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) euro dhe është likuiduar në këtë formë: 30.000 (tridhjetë mijë) euro në datën 2.4.2010 dhe 30.000 (tridhjetë mijë) euro në datën e nënshkrimit të kontratës së shitjes, në prani të noterit.

2.6 Shuma e përfutur nga shitja e këtij apartamenti është paguar *cash* dhe nuk rezultoi ndonjë transaksion bankar.

2.7 Subjekti deklaroi se nga vlera e shitjes së kësaj pasurie është shlyer totalisht kredia bankare në “Alpha Bank”, në prill 2010, në vlerën 2.410.583 (dy milionë e katërqind e dhjetë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e tre) lekë, e cila korrespondon me pagesën e deklaruar të përfutur nga shitja e apartamentit (kësti i parë).

2.8 Nga dokumentacioni⁷ i përcjellë konfirmohet disbursimi i kredisë në datën 18.10.2006 dhe shlyerja e saj më 27.4.2010 me depozitim *cash* të vlerës së mbetur nga subjekti.

2.9 Nga hetimi i llogarive bankare nuk rezultoi të jetë depozituar vlera e mbetur nga shitja e këtij apartamenti në llogaritë bankare të subjektit. Duket se vlerat e mbetura janë mbajtur *cash* nga subjekti.

2.10 Nga dokumentacioni i përcjellë rezultoi se shtetasi E. F. ka pasur në pronësi dy apartamente në lagjen “****”, Gjirokastrë, ku njëri prej tyre është apartamenti i blerë nga subjekti i rivlerësimit dhe tjeri vazhdon të jetë në pronësi të tij. Nga vëzhgimi i hartave treguese bashkëlidhur dokumentacionit të përcjellë duket se këto dy prona, të cilat kanë qenë në pronësi të shtetasit E. F. nuk janë prona kufitare me njera-tjetrën.

2.11 Gjatë hetimit, subjekti ka shpjeguar se apartamenti që ka blerë nga vjehtëri i tij në vitin 2006, në të vërtetë ka qenë në pronësi të kunatit z. K. F., i cili banonte në Greqi dhe e kishte blerë këtë apartament për veten e tij. Nisur nga marrëdhëniet e tyre e ngushtë familjare, nuk i është dukur i nevojshëm kalimi i pronësisë në emër të djalit të tij K. F.. Vjehtëri i subjektit E. F. ka kryer veprime për llogari të djalit të tij K. F., meqenëse ky i fundit ndodhej vazhdimisht në Greqi. Nga komunikimi verbal i subjektit me kunatin e tij, z. K. F., është sqaruar se shumë

⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 18.2.2020, e ASHK-së Gjirokastrë (përcjellë me pyetësorin e datës 7.2.2020).

⁶ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 24.10.2016, nga ZVRPP-ja Gjirokastrë (dosja ILDKPKI, Aneks 4/2).

⁷ Shkresë nga “Alpha Bank” “nxjerrje llogarie”, në dosjen ILDKPKI (Aneks 4/2) dhe shkresë nr. *** prot., datë 28.2.2019, e ardhur në Komision

veprime për llogari të z. K. F., i kryente babai i tij z. Ë. F. dhe për lehtësi ata kanë hapur llogari bankare me dy emra (K. F. dhe Ë. F.), kjo për faktin se në rast nevojë mund të kryente veprime bankare z. Ë. F., meqë K. ndodhej në Greqi.

2.12 Subjekti, i pyetur nga Komisioni, sqaron se kjo banesë është blerë fillimisht në shumën 700.000 (shtatëqind mijë) lekë nga kunati (*de facto*) në vitin 2002. Në funksion të saj ka vendosur në dispozicion Kontratën e Shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.12.2002 me shitës familjen T. (përkatësisht Z., I., A., K. dhe A. T.) dhe palë blerëse z. Ë. F. në të cilin vihet re se statusi i ndërtesës është në karabina.

2.13 Subjekti ka përcjellë në Komision edhe tri kontrata të shitjes së apartamenteve në të njëjtën ndërtesë me apartamentin e subjektit, të cilat kanë të njëjtën vlerë shitjeje dhe janë rreth të njëjtës periudhë shitjeje.

2.14 I pyetur nga Komisioni⁸ lidhur me shkaqet e rritjes së çmimit të apartamentit me sip. 88.8 m², nga vlera 3.700.000 (tre milionë e shtatëqind mijë) lekë në vitin 2006 në vlerën 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) euro (ose 8.170.200 lekë) në vitin 2010, nëse ka kryer investime në këtë apartament, të cilat mund të kenë ndikuar në rritjen e vlerës së apartamentit, subjekti shpjegon se nuk ka kryer ndonjë investim në këtë banesë. Gjithashtu, subjekti shpjegon se kunati i tij, z. K. F., e kishte mobiluar plotësisht dhe për këtë shkak kjo banesë u ble me një çmim të konsiderueshëm. Çmimi i blerjes së apartamentit përfshinte edhe mobilimin, i cili ishte realizuar nga kunati para momentit të shitjes së pronës.

2.15 Komisioni ka pyetur subjektin lidhur me burimin e të ardhurave për krijimin e kësaj pasurie në vitin 2002 dhe investimet e kryera deri në vitin 2006 të shtetasve E. dhe K. F., për të cilën subjekti ka shpjeguar se z. K. F. ka akumuluar të ardhura të mjaftueshme nga puna në Greqi, për të cilat ka vënë në dispozicion të dhënat nga Sigurimet Shoqërore në Greqi.

2.15.1 Në vijim, subjekti sqaron⁹ se kunati i tij kishte një projekt tjetër dhe donte ta shiste këtë banesë, prandaj dhe subjekti e bleu.

2.15.2 Subjekti ka paraqitur dokumentacion nga i cili rezulton se z. K. F. ka lidhur në datën 27.4.2012 një kontratë kredie me Bankën Kombëtare Tregtare, me palë kredimarrësit K. dhe E. F., në vlerën e kredisë prej 2.100.000 (dy milionë e njëqind mijë) lekësh, për blerjen e një apartamenti që kishte filluar ndërtimin nga shoqëria “***” sh.p.k., në bazë të Lejes së Ndërtimit nr. ***, datë 11.7.2008, të Bashkisë Gjirokastër. Në datën 25.4.2014 rezulton e lidhur Kontrata e Shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., me palë blerëse shtetasin K. F. dhe shitës shoqërinë “***” sh.p.k., të banesës me sip. 112.5 m² dhe një garazh, me çmim 3.460.000 (tre milionë e katërqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë. Çmimi i blerjes rezulton i likuiduar më parë.

2.16 Lidhur me apartamentin e blerë nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2006 rezultoi se çmimi i blerjes, krahasuar me çmimin e referencës sipas Udhëzimit nr. 5, datë 7.9.2006 (tabela nr. 2)¹⁰, është pak më i lartë se çmimi i referencës së zonës (kostoja e shitjes në lekë/m², për qytetin e Gjirokastrës do të jetë në vlerën 39.034 lekë/m²”, vlera e apartamentit me sip. 88.8 m², sipas EKB-së, në kohën kur është blerë apartamenti, ka qenë 3.466.219 lekë).

2.17 Në lidhje me çmimin e shitjes së apartamentit të banimit me Kontratën e Shitblerjes me nr. ***, datë 23.8.2010, krahasuar me çmimin e referencës sipas Udhëzimit nr. 3, datë 3.2.2010 (tabela nr. 2)¹¹, rezulton se çmimi i shitjes së banesës prej 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) euro i konvertuar në lekë¹², i cili përkon me vlerën 8.170.200 (tetë milionë e njëqind e shtatëdhjetë mijë e dyqind) lekë, është pothuajse dyfish më i lartë se çmimi i referencës së zonës (kostoja e shitjes në lekë/m² për qytetin e Gjirokastrës do të jetë në vlerën 48.035 lekë/m²”, vlera e apartamentit me sipërfaqe 88.8 m², sipas EKB-së në kohën kur është blerë apartamenti, vitit 2010, ka qenë në vlerën 4.265.508 lekë).

2.18 Subjekti, i pyetur¹³ nga Komisioni, shpjegoi në lidhje me çmimet e larta të shitjes se *çmimi i tjetërsimit nga ana e tij në vitin 2010 është bazuar në parimet e përgjithshme të vlerësimit të tregut, që aplikoheshin në zonën përkatëse. Sipas çmimeve të tregut në atë periudhë, vlera e*

⁸ Shihni përgjigjen nr. 2, në pyetësin e datës 3.9.2020.

⁹ Shihni përgjigjen nr. 1 në pyetësin e datës 3.9.2020.

¹⁰ Shihni Udhëzimin nr. 5, datë 7.9.2006 (tabela nr. 2).

¹¹ Shihni Udhëzimin nr. 3, datë 3.2.2010 (tabela nr. 2).

¹² Kursi zyrtar i Bankës së Shqipërisë në faqen zyrtare, datë 23.8.2010, është 136.17 lekë.

¹³ Shihni përgjigjet, për pyetësin e datës 3.2.2020 (pyetja 2).

pasurive të llojit 'apartament' varionte në çmimin 500 euro/m². Gjithashtu, sqaron se prona është tjetërsuar së bashku me mobilimin.

2.18.1 Subjekti paraqet në shpjegimet e tij dy vendime gjykatë¹⁴ që tregojnë çmimin real të pasurive. Këto vendime gjyqësore kanë pasur për objekt pjesëtimin e pasurisë bashkëshortore dhe ekspertët e gjykatës kanë vlerësuar për apartamentet me sipërfaqe të përafërta dhe në zona edhe më të dobëta se pallati i tij, një vlerë të përafërt me shitjen që ka bërë.

2.18.2 Subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur kontrata të ngjashme me çmimin e tij të shitjes së pasurisë apartament banimi me sipërfaqe 88.8 m², në Gjirokastrë.

2.19 Nga deklaratimet e subjektit ka rezultuar se shumë prej 38.000 (tridhjetë e tetë mijë) euro, mbetur nga shitja e apartamentit më 23.8.2010, pas likuidimit të kredisë dhe blerjes së një automjeti (trajtuar më poshtë), subjekti ia ka dhënë hua shtetasit B. N. (Deklarata Noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.3.2011).

2.20 Në përfundim, lidhur me këtë pasuri, Komisioni konstaton se çmimi i shitjes së saj në vitin 2010 është 221 % më i lartë se ai i blerjes dhe, njëkohësisht, disa herë më i lartë se çmimi i tregut. Sipas deklaratimeve të subjektit të rivlerësimit duket se nuk ka kryer asnjë investim në këtë apartament që prej vitit 2006 duke e shitur atë në vitin 2010 në të njëjtat kushte, por me një çmim disa herë më të lartë. Duket se veprimet për blerjen apo shitjen e kësaj pasurie i janë referuar çmimeve fiktive.

2.21 Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit për këtë pasuri.

2.22 Në vijim të rezultateve të hetimit subjekti ka shpjeguar se: *“Vlera e kësaj pasurie, në vitin kur unë e kam tjetërsuar, është padiskutim 60.000 euro. Pasuria është shitur së bashku me mobilimin e saj, është çmimi real i shitjes. Kjo ka qenë vlera e tregut të kësaj banese, e cila është shitur me gjithë mobilim. Referuar edhe përgjigjeve të mëparshme, unë ju kam vënë në dispozicion në cilësinë e provës dhe akteve referuese vërtetësinë e çmimit, dy vendime gjykatash që tregojnë çmimin e përafërt, i cili është çmim real jashtë tendencave që kanë palët e ndryshme kontraktore për të shmangur detyrimet fiskale dhe për këtë shkak shënojnë vlera shumë të ulëta në kontrata të ngjashme (kjo ndodh rëndom në Shqipëri).*

Prandaj edhe ka disa metoda vlerësimi të pronës, ku jo gjithnjë referohen në transaksionet e regjistruara pranë ish-ZVRPP-së. Një element i rëndësishëm që duhet të merret parasysh janë pikërisht vlerat e përlllogaritura të akteve të ekspertimit të kryera gjatë proceseve gjyqësore, të cilat kanë përfshirë një vlerësim të drejt dhe real, në përpjesëtim të drejtë me vlerat aktuale të tregut për pronën e paluajtshme.

Theksoj se diferenca e çmimit të banesës sime është thjeshtë rritje natyrale e çmimeve të banesave në të gjithë vendin, edhe në Gjirokastrë. Është fakt i njohur botërisht dhe eksperiencë e të gjithë njerëzve që kanë blerë apo shitur banesë që, çmimi i tyre sa vjen e rritet, nga viti në vit. Kjo ndodh në Tiranë, Durrës, Sarandë, Shkodër, Gjirokastrë, etj.”

2.23 Në përfundim, lidhur me këtë pasuri, trupi gjykues i Komisionit krijon bindjen se çmimi i shitjes së këtij apartamenti dy herë më i lartë se ai i blerjes së tij dhe për më tepër me sende e orendi të kahershme, të cilat logjikisht duhet të ishin amortizuar dhe pa asnjë investim të kryer ndër vite, është përtej logjikës ekonomike. Veprimet e subjektit të rivlerësimit, vlerësuar në tërësinë e tyre lidhur me këtë pasuri, blerjen e saj në vitin 2006 dhe burimin e të ardhurave për blerjen apo shitjen e saj në vitin 2010 e përdorimin e të ardhurave nga shitja, krijohet bindja se ato janë një sërë veprimesh fiktive të kryera nga subjekti i rivlerësimit me qëllim justifikimin e pasurive të përfituara prej tij, duke e vendosur atë në kushtet e një deklarami të rremë lidhur me këtë pasuri në kuptim të gërmës “ç”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

3. Hua shtetasit B. N., në shumë 38.000 (tridhjetë e tetë mijë) euro, sipas Deklaratës Noteriale nr. * rep., nr. *** kol., datë 29.3.2011.**

3.1 Nga verifikimi i DPV-së së vitit 2010 rezulton se subjekti i rivlerësimit deklaroi shumë 38.000 (tridhjetë e tetë mijë) euro të dhënë hua z. B. N., duke bashkëlidhur Deklaratën Noteriale të vitit 2011.

¹⁴ Shihni vendimin civil nr. ***, datë 15.5.2015 dhe vendimin civil nr. ***, datë 11.5.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë; aktekspertimin që shoqëron vendimin civil nr. ***.

3.2 Subjekti, i pyetur për këtë pasaktësi, shpjegon¹⁵ se: “... formularin (DPV-në e vitit 2010) e ka plotësuar në datën 31.3.2011 dhe ndërkohë që Akti Noterial i nënshkruar me z. B. N. është përpiluar në datën 29.3.2011, pra, tri ditë përpara plotësimit të Deklaratës në datën 31.3.2011 deklaruar kalimin e kësaj shume në DPV-në e vitit 2010”.

3.3 Në deklaratën noteriale¹⁶ përcaktohet se kjo shumë i është dorëzuar z. B. N. në tetor të vitit 2010 dhe afati i kthimit të saj nga z. B. N. është brenda dy vjetësh (jo më larg se marsi i vitit 2013). Në deklaratë është rënë dakord se kjo shumë do të kthehet në dy mënyra nga z. B. N.: *cash* ose me shitjen e një apartamenti në pallatin që po ndërtohet në Rr. “****”, mbi truallin e z. B. N. nga shoqëria ndërtuese “****” sh.p.k. Në rast të ngjarjes së dytë, pjesa tjetër e pagesës që detyrohet të paguajë z. Shkëlqim Mustafa për blerjen e apartamentit, do të arrihet me një marrëveshje pasi të ketë mbaruar apartamenti.

3.4 Sipas deklaratave të z. B. N. vërehet se nga vlera 38.000 (tridhjetë e tetë mijë) euro që z. Shkëlqim Mustafa i ka dhënë atij sipas Deklaratës me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.3.2011, i ka kthyer në datën 9.12.2011 në shumën prej 10.000 (dhjetë mijë) euro.

3.5 Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se një pjesë e ka përdorur dhe pjesën e mbetur e ka derdhur në bankë.

3.6 Në përfundim të hetimit për këtë pasuri, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të shpjegojë se përse nuk u realizua një marrëveshje mes palëve, brenda afatit dyvjeçar të parashikuar, si dhe shkaqet se pse z. B. N. i ktheu atij shumën prej 10.000 (dhjetë mijë) euro.

3.7 Në vijim të rezultateve të hetimit, subjekti ka shpjeguar se: “Shuma prej 10.000 euro të kthyer nga z. B. N., është kthyer prej tij për nevojat e mia të mobilimit të apartamentit të rënë dakord midis nesh për blerjen e saj. Pagesës fillestare që kam kryer për blerjen e apartamentit, nga 38.000 euro - 10.000 = 28.000 euro. Shuma e mësipërme nuk ka kundërshti nga ana e shitësit z. B. N., ndaj dhe lidhur me këtë pjesë nuk mund të ngrihet asnjë keqkuptim. Në kushtet kur apartamenti ishte tërësisht i pamobiluar, shuma prej 5.700 euro përfaqëson një vlerë proporcionale dhe bazike, të nevojshme për një apartament të ri, në përmasat e tij dhe modestinë e gëzimit të jetës nga familja jonë. Meqenëse këtë shumë e kam tërhequr fillimisht nga shtetasi B. N. dhe me pas e kam vendosur në bankë, për shkak se mendoja se pagesa për mobilim do të bëhej në fillim të porosisë së mobiljeve, por kjo pagesë u bë në fund pasi u përgatitën (prodhuan ose montuan) mobiljet e banesës.”

3.8 Trupi gjykues, në vlerësim të fakteve dhe rrethanave të rezultuara, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë një sërë deklarimesh të pasakta, të cilat duhet të vlerësohen në tërësinë e tyre në raport me pasurinë apartament banimi me sip. 126 m², ndodhur në një pallat shumëkatësh në Rr. “****”, Tiranë (pasuria nr. 4 më poshtë).

4. Pasuria apartament banimi me sip. 126 m², ndodhur në një pallat shumëkatësh në Rr. “****”, Tiranë. Subjekti ka deklaruar këtë pasuri në deklaratën *Vetting* me përshkrimin blerë nga z. B. N., duke shpjeguar se i ka dhënë atij vetëm shumën prej 28.000 (njëzet e tetë mijë) euro (sipas Deklaratave Noteriale me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.3.2011 dhe Deklaratës Noteriale me nr. *** rep., datë 9.12.2011). Shuma tjetër do të likuidohet me kredi në momentin e hipotekimit të kësaj pasurie. Subjekti deklaroi se mungesa e hipotekimit të kësaj pasurie ka sjellë vonesën e marrjes së kredisë për mungesë kolaterali.

4.1 Subjekti e deklaroi për herë të parë këtë pasuri në deklaratën *Vetting*, por deklaroi se banon në këtë apartament që prej datës 18.11.2012. Nga verifikimi i deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në DPV rezultoi:

- a) Në DPV-në e vitit 2010, subjekti deklaroi në rubrikën “Adresa e plotë ku jeni regjistruar në gjendjen civile” - *nuk ka ndyshim*. Nuk ka asnjë shënim në rubrikën “Nëse disponon vendqëndrim tjetër, adresa e plotë ku banon”.
- b) Në DPV-në e vitit 2011, subjekti nuk plotësoi rubrikën “Adresa e plotë ku jeni regjistruar në gjendjen civile”, as rubrikën “Nëse disponon vendqëndrim tjetër, adresa e plotë ku banon”. Subjekti nuk deklaroi zotërimin e apartamentit dhe as ndonjë marrëdhënie tjetër përdorimi/posedimi.

¹⁵ Shihni përgjigjen 3 të pyetësorit datë 3.9.2020.

¹⁶ Shihni listën e dokumenteve të përcjella për pyetësorin e datës 3.2.2020.

- c) Në DPV-në e vitit 2012, subjekti nuk plotëson rubrikën “Adresa e plotë ku jeni regjistruar në gjendjen civile”, as rubrikën “Nëse disponon vendqëndrim tjetër, adresa e plotë ku banon”. Subjekti nuk deklaron zotërimin e apartamentit dhe as ndonjë marrëdhënie tjetër përdorimi/posedimi.
- ç) Në DPV-në e vitit 2013, subjekti nuk plotëson rubrikën “Adresa e plotë ku jeni regjistruar në gjendjen civile”, as rubrikën “Nëse disponon vendqëndrim tjetër, adresa e plotë ku banon”. Në rubrikën “Ndryshime të interesave private pasuri të paluajtsme dhe të luajtshme”, subjekti deklaron “nuk ka ndryshime”, bashkëshortja deklaron “nuk ka pasuri”.
- d) Në DPV-në e vitit 2014, subjekti plotëson në rubrikën “Adresa e plotë ku jeni regjistruar në gjendjen civile” – Rr. “****”, Tiranë. Nuk bën asnjë shënim në rubrikën “Nëse disponon vendqëndrim tjetër, adresa e plotë ku banon”, në rubrikën “Ndryshime të interesave private pasuri të paluajtsme dhe të luajtshme”, subjekti deklaron “nuk ka ndryshime”, bashkëshortja nuk shënon asgjë.
- dh) Në DPV-në e vitit 2015, subjekti plotëson në rubrikën “Adresa e plotë ku jeni regjistruar në gjendjen civile” – Rr. “****”, Tiranë. Nuk bën asnjë shënim në rubrikën “Nëse disponon vendqëndrim tjetër, adresa e plotë ku banon”, në rubrikën “Ndryshime të interesave private pasuri të paluajtsme dhe të luajtshme”, subjekti deklaron “nuk ka ndryshime”, bashkëshortja nuk shënon asgjë.
- e) Në DPV-në e vitit 2016, subjekti nuk shënon asnjë të dhënë në rubrikën “Adresa e plotë ku jeni regjistruar në gjendjen civile”. Nuk bën asnjë shënim në rubrikën “Nëse disponon vendqëndrim tjetër, adresa e plotë ku banon”, në rubrikën “Ndryshime të interesave private pasuri të paluajtsme dhe të luajtshme”, subjekti deklaron “nuk ka ndryshime”, bashkëshortja nuk shënon asgjë.
- ë) Në deklaratën *Vetting* subjekti nuk plotëson rubrikën “Adresa e plotë ku jeni regjistruar në gjendjen civile”, plotëson rubrikën “Nëse disponon vendqëndrim tjetër, adresa e plotë ku banon” – Rr. “****”, Tiranë. Në rubrikën “Deklarimi i pasurive”, subjekti deklaron për herë të parë: *“Apartament banimi me sip.126 m², blerë nga z. B. N., të cilit i kam dhënë vetëm shumën prej 28.000 euro, ndërsa shuma tjetër do të likuidohet me kredi në momentin e hipotekimit të shtëpisë”*.

4.2 Subjekti i rivlerësimit, i pyetur gjatë hetimit administrativ, ka shpjeguar se kjo pasuri figuron në pronësi të shoqërisë “****” sh.p.k., pasi ndodhet ende në proces gjyqësor¹⁷ me pronarët e truallit (z. B. N.). Në shpjegimet e tij, subjekti vijon duke sqaruar se z. B. N., në cilësinë e pronarit të tokës, ka përfitur disa banesa nga ndërtimi i këtij pallati dhe i ka shitur një banesë me sip. 122.6 m² (gabimisht subjekti e mendonte 126 m²)¹⁸, e cila është dorëzuar dhe përfunduar me kushtet optimale për banim. Subjekti shpjegon, ndër të tjera, se vlera që ka përdorur për mobilimin kryesor të banesës¹⁹ (e cila përfshin nevojat bazike të jetesës) ka qenë në shumën 5.700 (pesë mijë e shtatëqind) euro.

4.3 ASHK-ja Tiranë²⁰, në korrespondencë me Komisionin, ka përcjellë informacion mbi ambientet e banimit, të cilat rezultonin në emër të shoqërisë “****” sh.p.k. Në lidhje me këtë pasuri, pas verifikimit të të dhënave dhe shkresave të administruara nga zyrat e ASHK-së, rezultoi se prona e mësipërme kishte sipërfaqe faktike prej 109.83 m². Në bazë të Lejes së Përdorimit nr. *** prot., datë 31.5.2013, është lëshuar kartela e pasurisë për këtë pasuri me nr. pronësie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, sip. 109.83 m² dhe pronar shoqërinë “****” sh.p.k. Mbi këtë pasuri është vendosur në datën 22.8.2013 bllokim dhe kufizim veprimesh deri në realizimin e kontratës së shkëmbimit me pronarët e truallit.

4.4 Lidhur me pagesat për furnizimin me energji elektrike, subjekt i i rivlerësimit ka përcjellë²¹ librezën nga OSHEE-ja në emër të z. B. N. me Kontratën nr. ***. Subjekti deklaron,²² ndër të tjera, se paguan për shërbimin e marrë për furnizimin me energji elektrike për aq sa konsumon.

¹⁷ Shihni dokumentet e cituara në pikën 25 më sipër (të përcjella me pyetësin e datës 3.2.2020).

¹⁸ Shihni përgjigjen e pyetjes nr. 3, të pyetësit datë 9.9.2020.

¹⁹ Shihni në dosje foto të apartamentit.

²⁰ Shkresa në dosjen e Komisionit me nr. ***, datë 15.9.2020.

²¹ Shihni kopjen e librezës së OSHEE-së të përcjellë me listën e dokumenteve për pyetësin e datës 7.2.2020.

²² Shihni përgjigjen e pyetjes 6, në f. 6 (në përgjigjet e pyetësit më 3.2.2020 dhe më 7.2.2020).

4.5 Lidhur me pagesat për furnizimin me ujë, subjekti ka përcjellë²³ librezën e ujit, me Kontratë nr. ***, zona ***, p. ***, sek. ***, k. ***, ap. ***, lëshuar shoqërisë “****” sh.p.k. Subjekti deklaron se paguan për shërbimin e marrë për furnizimin me ujë për aq sa konsumon.

4.6 Çmimet e tregut të lirë të apartamenteve për qytetin e Tiranës sipas EKB-së²⁴, në vitin 2010 janë në vlerën 130.000 lekë/m² për zonën nr. 9/1. Vlera e apartamentit sipas EKB-së, shkon në shumën 15.938.000 (pesëmbëdhjetë milionë e nëntëqind e tridhjetë e tetë mijë) lekë.

4.6.1 Nga hetimi i Komisionit rezultoi se pronat e shoqërisë “****” sh.p.k. janë regjistruar në zyrat e ASHK-së në bazë të shkresës datë 31.5.2013, të Bashkisë Tiranë. Referuar çmimeve sipas EKB-së²⁵ për qytetin e Tiranës për vitin 2013 vlera e apartamentit është 136.200 lekë/m² për zonën nr. 9/1 ose në vlerë absolute 16.698.120 (gjashtëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e njëqind e njëzet) lekë.

4.6.2 Mbështetur në rezultatet e mësipërme duket se subjekti ka paguar një vlerë relativisht shumë të ulët me vlerën sipas çmimeve të referencës, por edhe më të ulët referuar vlerës së tregut.

4.7 Komisioni ka kryer korrespondencë me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë²⁶ dhe Gjykatën e Apelit Tiranë²⁷, ku i ka kërkuar informacion në lidhje me çështjet gjyqësore, me shtetasin B. N..

4.7.1 Këto gjykata²⁸ kanë konfirmuar se nga verifikimi nuk rezultoi që të ketë pasur çështje gjyqësore apo të jenë dhënë vendime ndaj shtetasit B. N., të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit.

4.7.2 Gjykata e Apelit Tiranë²⁹ ka konfirmuar se në ngarkim të shtetasit B. Sh. N. figurojnë të gjykuara 3 çështje gjyqësore, të gjykuara nga gjyqtarë të tjerë, përkatësisht: çështja civile me nr. *** vendimi, datë 28.2.2008; çështja civile me nr. *** vendimi, datë 3.4.2015; si dhe çështja penale me nr. *** vendimi, datë 7.2.2018. Nga informacionet ka rezultuar një proces penal lidhur me një pasuri të pretenduar nga shtetasi B. N., pikerisht banesa nr. ***, ndodhur në Rr. “****”, Tiranë, e cila korrespondon edhe me adresën e dhënë nga subjekti i rivlerësimit në regjistrin e gjendjes civile.

4.7.3 Në përfundim, nuk kanë rezultuar të dhëna apo *indicie* për veprime të mundshme në kushtet e konfliktit të interesit nga subjekti i rivlerësimit.

4.8 Si burim për krijimin e vlerës prej 38.000 (tridhjetë e tetë mijë) euro, dhënë hua shtetasit B.N., subjekti deklaron se kanë shërbyer të ardhurat nga shitja e apartamentit në Gjirokastër.

Mënyra e përdorimit të të ardhurave nga shitja e apartamentit	Vlera dhe periudha	Vlera e shitjes së apartamentit
Shlyerja e kredisë në “Alpha Bank”	2,410,583 lekë – 17,412 euro, datë 18.10.2010	Kësti i parë: vlera 30,000 euro, datë 2.4.2010
Blerja e automjetit tip “****”	5,000 euro, datë 8.7.2010	Kësti i parë: vlera 30,000 euro, datë 2.4.2010
Dhënie hua, z. B. N.	38,000 euro, tetor 2010	Kësti i dytë: vlera 30,000 euro, datë 23.8.2010
Totali	60,412 euro	60,000 euro

* Nga sa më sipër, rezulton një diferencë prej 412 (katërqind e dymbëdhjetë) euro, të cilat mund të jenë edhe si efekt i kursit të këmbimit.

4.9 Nga hetimi i Komisionit për këtë pasuri rezulton se:

- Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk kanë deklaruar në deklaratimet periodike vjetore blerjen e këtij apartamenti apo porositjen e tij, nuk kanë deklaruar zotërimin/posedimin e këtij sendi në deklaratimet periodike vjetore, si dhe nuk e kanë deklaruar këtë pasuri as si adresë banimi në DPV.
- Nga hetimi rezulton se nuk ka asnjë kontratë apo marrëveshje të deklaruar nga subjekti për blerjen/këmbimin apo porositjen e këtij apartamenti dhe se pretendimet e tij gjatë hetimit administrativ të Komisionit nuk rezultojnë të provuara në deklaratimet periodike vjetore dhe as në ndonjë dokument të hershëm.
- Sipërfaqja e apartamentit që zotëron subjekti i rivlerësimit (si pasuri e pretenduar nga z. B. N.), aktualisht është ende në pronësi të shoqërisë “****” sh.p.k., e bllokuar për shkak të

²³ Shihni kopjen e librezës së ujit, të përcjellë me listën e dokumenteve për pyetësorin e datës 7.2.2020.

²⁴ Udhëzimi nr. 3, datë 3.2.2010.

²⁵ Udhëzimi nr. 1, datë 8.5.2013.

²⁶ Shihni shkresën e ardhur në Komision nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

²⁷ Shihni shkresën e ardhur në Komision nga Gjykata e Apelit Tiranë.

²⁸ Shihni shkresën nr. ***, datë 10.2.2020, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe shkresën nr. *** prot., datë 6.2.2020, nga Gjykata e Apelit Tiranë.

²⁹ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 24.8.2020, nga Gjykata e Apelit Tiranë (bashkëngjitur 3 vendimet gjyqësore me palë B. Sh. N.).

- konfliktit që shoqëria ndërtuese ka me z. B. N. dhe rezulton sipas dokumenteve me sip. 108 m² dhe jo 126 m² sa është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit. Duket se subjekti i rivlerësimit zotëron edhe një pasuri tjetër për të cilën nuk dihet origjina e saj.
- ç) Çmimi prej 28.000 (njëzet e tetë mijë) euro i dhënë hua shtetasit B. N., i pretenduar si paradhënie për blerjen e këtij apartamenti në vitin 2010, është një çmim shumë herë më i ulët, krahasuar me vlerën e tregut për apartamentet në këtë zonë apo referuar çmimit të referencës si në vitin 2011 edhe në vitin 2013, kur ky pallat është regjistruar ashtu edhe sot (viti 2020), ku rezulton se ende nuk ka një kontratë shkëmbimi/porosie apo premtim shitje për këtë apartament mes palëve dhe se vlera sipas shpjegimeve të subjektit rezulton ende e pashlyer dhe e pa përcaktuar.
- d) Subjekti i rivlerësimit nuk deklaron në deklaratën *Vetting* dhe as në DPV detyrimin e tij për këtë apartament, që duket se e zotëron prej vitit 2011, përkundrajt një pagese shumë herë më të vogël se kostoja reale e kësaj pasurie.
- dh) Duket se subjekti i rivlerësimit ka kryer fshehje të pasurisë ndër vite, ka fshehur çmimin real të blerjes së kësaj pasurie në deklaratën *Vetting*, si dhe detyrimin real ndaj z. B. N.. Subjekti duket se ka zotëruar jo në mënyrën e duhur ligjore pasurinë për të cilën ngrihen dyshime mbi ligjshmërinë e krijimit të saj.

4.10 Subjektit i kaloi barra e provës bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, për të shpjeguar bindshëm për Komisionin lidhur me problematikat e konstatuara për këtë pasuri.

4.11 Në vijim të rezultateve të hetimit subjekti shpjegon: *“Vlera prej 38.000 euro e rënë dakord në Deklaratën Noteriale të datës 29.3.2011, përfaqëson këstin e parë të detyrimit për pagimin e çmimit, si këst i cili do t’i zbritej vlerës përfundimtare të çmimit të shitjes në kontratën e shitjes përfundimtare që do të lidhnim në momentin e plotësimit të kushteve me sipërmarrësin e ndërtimit.*

Deklarata, të cilën e kam cituar edhe më parë, është një kontratë shitje me rezervë, e cila në thelb është një kontratë shitje me rezervë edhe ngaqë për ne ka qenë konsideruar e tillë dhe ka mjaftuar për vlefshmërinë e saj përkundrajt ne subjekteve, përputhet plotësisht edhe me dispozitat e Kodit Civil, neni 746 i tij, në të cilën përcaktohet se ‘kur çmimi i shitjes paguhet me këste, blerësi e fiton pronësinë e sendit me pagimin e këstit të fundit të çmimit, duke marrë përsipër rreziqet që në çastin e dorëzimit’.

Sipas marrëveshjes sonë dhe vetë natyrës së një marrëdhënieje të tillë juridike, vlera e mbetur e detyrimit, do të përcaktohej në një marrëveshje të dytë, në momentin e regjistrimit të sendit dhe sigurimit të një kredie bankare duke lënë garanci pasurinë apartament. Regjistrimi i sendit, sikundër dihet ligjërisht, është kusht thelbësor për disbursimin e një kredie bankare, e cila kërkon gjithmonë një kolateral (pasurinë e paluajtshme) për të bërë të mundur dhënien e shumës. Në kushtet kur unë nuk disponoj asnjë pasuri të paluajtshme mbi të cilën ta vendos si kolateral për blerjen e apartamentit, e kam të pamundur ta vlerësoj këtë situatë mbi mundësinë e marrjes së një kredie bankare dhe po kështu, nuk ka se si dhe pala shitëse, të kërkojë çmimin e plotë të apartamentit.

*Pasuria konkrete ku unë dhe familja ime banojmë, objekt i marrëveshjes noteriale të lidhur midis meje dhe z. B. N., është pikërisht pasuria me nr. apartament ***, sipërfaqe (122.66 m²), kati i *** (pjesë e objektit të shqyrtimit gjyqësor të padisë).*

*Si origjinë e identifikimit të saktë të kësaj pasurie shërben referimi në kontratën e sipërmarrjes së lidhur në vitin 2010, ku kjo pasuri identifikohet me planimetrinë bashkëngjitur saj dhe konkretisht me pasurinë me nr. ***, sipërfaqe ndërtimi në total 122.64 m². Kjo është pasuria ku unë banoj dhe mbi të cilën ka rënë dakord pronari i truallit me sipërmarrësin, përcaktuar qartësisht në nenin 4, paragrafi 6, pjesa e dytë e fjalisë së tretë të saj, ku përcaktohen qartësisht sipërfaqet e ndërtimit që përfitojnë pronarët në objektin në fjalë.*

I gjendur në një pasiguri për ecurinë e konflikteve që z. B. N. ka pasur me ndërtuesin, konflikte të cilat vazhdojnë të ekzistojnë ende, atëherë marrëveshja e realizuar me z. N. në vitin 2011, ka ende vlefshmëri juridike, për sa kohë kushti thelbësor i regjistrimit të pasurisë nuk është realizuar ende. Pra, në referim të ligjit, do e kisha të pamundur të realizoja një kontratë përfundimtare të shitjes, duke paguar dhe pjesën e mbetur të detyrimit, për sa kohë që konfliktet

ligjore me ndërtuesin ende nuk kanë përfunduar për z. N. dhe pasuria objekt kontrate nuk është regjistruar ende në hipotekë.

Unë kam deklaruar në mënyrë korrekte dhe në kohën e duhur çdo akt noterial që ka formalizuar marrëveshjen time me shtetasit B. e E. N. për blerjen e apartamentit ku unë banoj.

Unë çdo veprim juridik për blerjen e këtij apartamenti, të kryer deri në këto momente e kam deklaruar qartësisht pa asnjë hezitim. Siç ju përshkrova më lart gjendjen juridike të pronës, unë kam kryer të gjitha veprimet e mundshme juridike të formalizuara në akte noteriale. Është pikërisht gjendja juridike e bllokimit të kësaj pasurie që më pengon për kryerjen e veprimeve të tjera juridike për finalizimin e çdo veprimi juridik që do të mundësonte kalimin e këtij apartamenti në pronësinë time. Pra, unë nuk kam shfaqur aspak vullnet për mosdeklarim, por kam deklaruar çdo veprim juridik, si dhe kam ekspozuar saktësisht dhe në mënyrën më transparente të mundshme të gjitha aktet noteriale. Ekspozimi i ekstremitetëve të akteve noteriale, si dhe dorëzimi fizik i tyre në deklarimet periodike është deklarimi më i plotë ligjor dhe maksimalisht transparent”.

4.12 Në përfundim, lidhur me këtë pasuri, trupi gjykues vlerëson se deklarimet e subjektit në deklaratën *Vetting* janë të paplota e të pamjaftueshme. Ai nuk deklaroi vlerën reale të kësaj pasurie dhe detyrimin ndaj shtetasit B. N. apo detyrimin e mbetur për apartamentin e zotëruar prej tij, duke e fshehur atë.

4.12.1 Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm në deklarimet periodike vjetore, duke krijuar kështu vështirësi në kryerjen e veprimeve për verifikimin e kësaj pasurie dhe duke fshehur situatën reale të pasurive të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të.

4.12.2 Nga vlerësimi në tërësi i veprimeve dhe mosveprimeve të subjektit lidhur me këtë pasuri, trupi gjykues krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarim të rremë në deklaratën *Vetting*, si lidhur me çmimin real të saj, po ashtu edhe lidhur me sipërfaqen e objektit të zotëruar prej tij duke u klasifikuar në kushtet e germës “ç”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

5. Automjet tip “**”, me targa ***, blerë sipas Kontratës³⁰ nr. *** rep., datë 3.3.2003, në vlerën 100.000 (njëqind mijë) lekë me kursimet familjare.** Nga dosja e automjetit rezultoi se ky automjet ka ardhur nga Italia me vlerë 1.000.000 (një milion). Për këtë automjet është paguar taksa doganore në shumën 131.793 (njëqind e tridhjetë e një mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e tre) lekë dhe është regjistruar në emër të shtetasit A. B.. Ky shtetas, në datën 15.3.2002, ia dhuron automjetin shtetasit Gj. M., i cili në datën 3.3.2003 ia shet atë shtetasit Shkëlqim Mustafa në vlerën 100.000 (njëqind mijë) lekë.

5.1 Kjo pasuri është tjetërsuar (me shkëmbim) me automjetin e tipit “****”, me targa *** nëpërmjet Kontratës së Këmbimit³¹ nr. ***, datë 31.7.2003, me palë shtetasit K. G. dhe Shkëlqim Mustafa. Shtetasi K. G. i shet automjetin në datën 22.10.2003 shtetasit M. M. në shumën 250.000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

5.2 Në DPV-në e vitit 2003, subjekti i rivlerësimit nuk e deklaroi këmbimin e automjetit tip “****”, por në deklarimin për automjetin tip “****” (pasuria nr. 6 më poshtë), shpjegon se si burim i kësaj pasurie ka shërbyer këmbimi me automjetin tip “****”, me targa ***.

5.3 DPSHTRr-ja³² konfirmon në emër të subjektit të rivlerësimit automjetin e mësipërm me targa ***, i cili rezultoi të jetë blerë nga shtetasi K. G. me Kontratën e Këmbimit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 31.7.2003 dhe subjekti i rivlerësimit bëhet pronar i automjetit tip “****”, me targa ***.

5.4 Subjekti i rivlerësimit deklaroi se si burim i krijimit të pasurisë automjet “****”, me targa *** kanë shërbyer kursimet familjare deri në datën e blerjes (më 3.3.2003). Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie (“****”) në vlerën 100.000 (njëqind mijë) lekë rezultoi se subjekti ka pasur mundësi të mjaftueshme për të krijuar pasurinë me burimet e deklaruara.

5.5 Për Komisionin duket i dyshimtë çmimi prej 100.000 (njëqind mijë) lekësh i blerjes së këtij automjeti, në vlerësim të historikut të saj si lidhur me çmimin e saj në momentin e ardhjes në pikën kufitare, ashtu edhe me çmimin e shitjes nga pala me të cilin z. Shkëlqim Mustafa e ka këmbyer këtë pasuri, mbajtur në konsideratë edhe legjislacioni fiskal për automjetet i cili

³⁰ Shihni kontratën e shitjes në dosjen ILDKPKI, aneks 4/3.

³¹ Shihni kontratën e shitjes në dosjen ILDKPKI, aneks 4/3.

³² Shihni Kontratën e Këmbimit nr. ***, datë 31.7.2003, në dosjen e ILDKPKI-së (aneks 4/3).

parashikon normë vjetore amortizimi për pasuritë e luajtshme, duke e klasifikuar subjektin e rivlerësimit në kushtet e germës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

6. Automjeti tip “**”,** me targa ***, i fituar me Kontratën e Këmbimit të datës 31.7.2003 është shitur me Kontratën³³ e Shitjes nr. ***, datë 1.7.2004, në vlerën 250.000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë (jashtë zyrës noteriale) me palë shtetasit A. P. dhe Shkëlqim Mustafa (pjesa takuese 100 %).

6.1 Lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie, subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting*, se ky automjet është blerë nëpërmjet Kontratës së Këmbimit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 31.7.2003, me palë z. K. G. dhe z. Shkëlqim Mustafa.

6.2 Sa më sipër, rezulton se subjekti ka blerë automjetin tip “****”, me targa ***, në vlerën e deklaruar 100.000 (njëqind mijë) lekë, të cilën duket se e ka blerë më lirë se vlera në kosto e automjetit. Ai e ka shkëmbyer këtë automjet brenda një periudhe 4-mujore me automjetin tip “****”, me targa ***, të cilin e ka shitur në datën 1.7.2004, rreth 11 muaj më vonë në vlerën e deklaruar 250.000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

6.3 Në përfundim, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të shpjegojë lidhur me shumën e përfituar prej 250.000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekësh nga shitja e automjetit në vitin 2004, pasi duket se ai ble automjete nën kosto dhe i shet me fitim.

6.4 Në vijim të rezultateve të hetimit, subjekti ka shpjeguar: *“Në këndvështrimin historik të këtij automjeti, fillimisht dua të sqaroj Komisionin se automjetit i tipit ‘****’, i vitit 1985 me targa ***, blerë në vitin 2003, ka ardhur për herë të parë nga Italia në datën 18.9.2001. Unë e kam blerë këtë automjet në datën 3.3.2003, pra, dy vite e dy muaj më vonë nga momenti kur automjeti ka mbërritur në Shqipëri.*

*Në përcaktimin e amortizimit të automjetit merret në konsideratë jetëgjatësia e mbetur e tij, dhe në rastin e një automjeti ‘****’, i vitit 1985, është e vetëkuptueshme që vlera e një automjeti të tillë nuk ka sesi të jetë e lartë.*

*Në lidhje me automjetin tip ‘****’, me targa ***, i fituar me Kontratën e Këmbimit të datës 31.7.2003 dhe shitur me Kontratën e Shitjes nr. ***, datë 1.7.2004, në vlerën 250.000 lekë me palë z. A. P. dhe z. Shkëlqim Mustafa, nga Komisioni ngrihen pretendime lidhur me pagimin e tatimit mbi fitim lidhur me shumën e përfituar prej 250.000 lekësh. Në lidhje me pagimin e tatimit mbi fitim, sqaroj se kontratat që kam lidhur për këto automjete janë kontrata shkëmbimi, ndaj dhe kur nuk ka një të ardhur konkrete të përfituar në vlerë monetare, nuk ka as gfarë tatimi mbi të ardhurat të paguhet. Shkëmbimi i këtyre automjeteve nuk ka çmime referuese sikundër mund të kenë pasuritë e paluajtshme për efekt të tatim-fitimit. Duke qenë të tilla nuk ka një mënyrë të tatimit mbi një të ardhur që në thelb nuk është përfituar, por vetëm shkëmbyer. Vlera e shpërblimeve në natyrë, e cila nënkupton çdo shpërblim të paguar jo në para por në natyrë, vlera e shpërblimeve në natyrë është shpenzim i panjohur për shkak të faktit se ato nuk taten si të ardhura personale në zbatim të legjislacionit tatimor”.*

6.5 Në përfundim, Komisioni vlerësoi bindëse shpjegimet e subjektit lidhur me këtë pasuri.

7. Automjeti tip “**” (****),** viti i prodhimit 2002, me targa ***, blerë me Kontratën e Shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.7.2010, me palë shtetasit K. F. (kunati i subjektit) dhe Shkëlqim Mustafa, në vlerën 5.000 (pesë mijë) euro, likuiduar jashtë zyrës noteriale. Deklaruar në DPV-në e vitit 2010.

7.1 DPSHTRr-ja³⁴ konfirmon në emër të subjektit automjetin e mësipërm me targa ***, i cili rezulton i blerë nga shtetasi K. F. me Kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.7.2010, në shumën 5.000 (pesë mijë) euro. Ky automjet rezulton të ketë pasur targën ***, e cila ka ndryshuar me kërkesë të subjektit të rivlerësimit në targën ***.

7.1.1 Nga dosja rezulton se subjekti ka paraqitur një kërkesë në datën 14.1.2011, në DRSHTRr Tiranë (kërkesa nr. *** prot.) me anë të së cilës kërkon transferimin e dosjes së automjetit nga Gjyrokastri në Tiranë, pasi ai ka vendbanimin në Tiranë sipas vërtetimit nr. ***, datë 12.1.2011.

7.2 Sipas dokumentacionit për këtë pasuri rezulton se:

³³ Shihni kontratën e shitjes në dosjen ILDKPKI (Aneks 4/3).

³⁴ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 4.3.2019, nga DPSHTRr-ja.

- a) Automjeti ka hyrë në territorin e Shqipërisë nga pika doganore Kakavijë në datën 4.3.2009, i pajisur me targa *** me destinacion “qëndrim i përkohshëm” nga shtetasi T. Sh.. Certifikata e Pronësisë e mëparshme e automjetit tregon se vendi i origjinës së këtij automjeti ka qenë Italia. Sipas dokumentit të përcjellë nga pika doganore Kakavijë vlera e automjetit rezultoi 7.000 (shtatë mijë) euro dhe shpenzime të paguara për zhdoganim, etj., në vlerën 446.337 (katërqind e dyzet e gjashtë mijë e treqind e tridhjetë e shtatë) lekë, deklaruesi Sh. B..
- b) Shtetasi K. F. (kunati i subjektit) rezultoi ta ketë blerë këtë automjet një ditë pasi shtetasi T. Sh. e ka sjellë atë, me Kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.5.2009, në vlerën 1.200.000 (një milion e dyqind mijë) lekë (rreth 8.750 euro)³⁵ nga shtetasi T. Sh., duke e pajisur me targa ***.
- c) Subjekti i rivlerësimit, z. Shkëlqim Mustafa, e ka blerë këtë automjet me Kontratën e Shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.7.2010, në vlerën 5.000 (pesë mijë) euro, likuiduar jashtë zyrës noteriale duke i ndryshuar targat në ***, si dhe duke e deklaruar këtë pasuri në DPV-në e vitit 2010.

7.3 Në lidhje me shitjen e automjetit të mësipërm nga z. K. F. me çmim më të ulët se çmimi i blerjes nga ana e tij, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar³⁶ se: *“K. F. është vëllai i bashkëshortes dhe çmimi i shitjes është si pasojë e marrëdhënies së ngushtë familjare që ka ekzistuar dhe vazhdon të ekzistojë me kunatin e tij. Kur bëhet fjalë për një marrëdhënie familjare, sidomos në mentalitetin shqiptar ku jetojmë, mendohet gjithnjë që të lehtësojmë dhe të mos rëndojmë pozitat e secilit në marrëdhënie të posaçme dhe të mos mundohemi të përfitojmë në masa absolute. Gjithnjë ka një subjektivitet në aspektin kontraktual. Në rastin konkret, shitja me një vlerë më të vogël vjen si pasojë jo vetëm e faktit që makina amortizohet dhe brenda një harku kohor të shkurtër mund t’i ulet vlera në mënyrë të dukshme, por edhe për arsye se makina në ato muaj kishte udhëtuar mjaftueshëm dhe kunati kishte vendosur të mos e përdorte më dhe i duhej ta shiste shpejt.”*

7.4 Lidhur me burimin e krijimit, subjekti deklaroi si burim shumë të përfituar nga shitja e apartamentit me sip. 88.8 m², në Gjirokastër (pasuria nr. 2 më sipër) e shitur sipas Kontratës datë 23.8.2010, ku pagesa e kësteve është përshkruar në datën 2.4.2010 (30.000 euro) dhe kësti i dytë në datën 23.8.2010. Gjithashtu, subjekti deklaroi se ka përdorur të ardhurat e shitjes së apartamentit për të mbyllur kredinë në “Alpha Bank” në vlerën 2.410.583 lekë ~ 17.412³⁷ (shtatëmbëdhjetë mijë e katërqind e dymbëdhjetë) euro, të cilat në total me vlerën e blerjes së automjetit rezultojnë të jenë 22.412 (njëzet e dy mijë e katërqind e dymbëdhjetë) euro.

7.5 Subjekti, pasi është pyetur³⁸ nga Komisioni, sqaroi se ky automjet ka qenë në pronësi të shtetasit K. F., që është dhe vëllai i bashkëshortes së tij. Ai vazhdimisht ka kryer aktivitet në fushën e duralumineve me dy shokët e tij, që kishte punuar në Greqi dhe ka akumuluar të ardhura të mjaftueshme. Për shkak të marrëdhënies familjare, ai e ka përdorur këtë automjet në dy – tri udhëtime në Greqi. Nuk ka përdorur automjete të tjera apo të personave të tjerë.

7.6 Sipas sistemit TIMS shtetasi K. F. nuk rezultoi të ketë qenë në Shqipëri në datën e blerjes së automjetit, si dhe në të gjitha hyrje-daljet e tij ky shtetas ka përdorur një automjet tjetër me targa *** dhe në asnjë rast nuk rezultoi të ketë përdorur automjetin me targa ***.

7.7 Në sistemin AMF, policat e sigurimit për këtë automjet rezultojnë: (1) fillimisht me targa ***, TPL figuron në emër të z. Shkëlqim Mustafa që prej datës 20.5.2009 – 2010 e deri në vitin 2011 kur është bërë edhe ndryshimi i targës; (2) për targën *** po ashtu TPL figuron në emër të subjektit të rivlerësimit, z. Shkëlqim Mustafa. Nga ky dokumentacion duket se subjekti, së fundmi, e ka shitur këtë automjet, por nuk rezultoi e deklaruar prej tij. Që prej vitit 2019 ka figuruar si përdorues i këtij automjeti edhe shtetasi S. M..

7.8 Nga verifikimi në sistemin TIMS rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka udhëtuar rregullisht me këtë automjet (me targa ***) si drejtues i tij në datat 21.5.2009, 29.5.2009, 26.3.2010, 9.5.2010, si dhe në vijim me këtë automjet, po me targa ***.

7.9 Nga hetimi për këtë pasuri ka rezultuar:

³⁵ Sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë, më 17.5.2009.

³⁶ Pyetja 9 në pyetësorin e datës 10.8.2020.

³⁷ Sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë më 16.4.2010.

³⁸ Shihni pyetjen 3 në përgjigjet e pyetësorit datë 3.9.2020.

- a) Shtetasi T. Sh. e ka blerë këtë automjet në Greqi dhe e ka shitur te shtetasi K. F., një ditë më vonë, duket se në vlerë të barabartë ose pak më të ulët me shpenzimet e kryera. Ky i fundit e ka mbajtur automjetin për rreth 14 muaj (sipas dokumentacionit) dhe më tej ia ka shitur atë subjektit të rivlerësimit në datën 8.7.2010 për një vlerë më të ulët se ajo e blerjes. Shtetasi K. F., sipas të dhënave nga sistemi TIMS, nuk rezulton ta ketë përdorur në asnjë rast këtë automjet, megjithëse hyn dhe del vazhdimisht në pikën kufitare duke përdorur automjetin e tij me targa greke.
- b) Komisioni ka dyshime se ky automjet është blerë nga subjekti i rivlerësimit që në vitin 2009 dhe se veprimet e kryera për tjetërsimin e pronës janë fiktive për të fshehur çmimin real të blerjes së kësaj pasurie, si dhe kohën e blerjes lidhur me burimin e deklaruar të të ardhurave për krijimin e saj.
- c) Komisioni ka dyshime se subjekti i rivlerësimit nuk e përdor më këtë automjet, por nuk ka deklaruar tjetërsimin e tij.

7.10 Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të shpjeguar bindshëm për Komisionin lidhur me dyshimet e ngritura për këtë pasuri.

7.11 Në vijim të rezultateve të hetimit, lidhur me këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar: *“... dua të theksoj sërish se kjo marrëveshje për blerjen e automjetit është lidhur me kunatin tim, z. K. F., i cili është vëllai i bashkëshortes sime. Automjetin kunati im e ka blerë nëpërmjet Kontratës me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.5.2009, në vlerën 1.200,000 lekë, me palë shitëse shtetasin T. Sh.. Në dijeninë time, automjetin, kunati im e ka blerë në një marrëdhënie kleringu, për sa kohë kunati ka aktivitetin e tij tregtar në shtetin grek, dhe shkëmben mallra me palë të treta, për shkak të vetë marrëdhënies që ka në fushën e duralumineve.*

Pasi nënshkroi këtë marrëveshje shitblerjeje dhe meqenëse kunati ka punuar dhe ka jetuar gjithnjë në shtetin grek, më kërkoi që të kujdesesha për automjetin, të ruaja aktivitetin jetësor të këtij automjeti për sa kohë dihet që automjeti është një send, i cili amortizohet me kalimin e kohës, bateria duhet ndezur herë pas here që të mos kalojë në ezaurim dhe shuarje, meqenëse sapo kishte marrë në dorëzim automjetin, por i duhej ndërkohë që të vazhdonte të qëndronte në shtetin grek. Meqenëse i duhej të ishte prezent në shtetin shqiptar në mënyrë që të përpilonte të gjithë dokumentacionin për sigurimin e detyrueshëm TPL, lejen e qarkullimit etj., si dhe në kushtet kur ekziston kjo marrëdhënie kaq e afërme, mora përsipër të plotësoj dokumentacionet e automjetit në emrin tim, për sa kohë në emër të tij nuk do mundesha pasi nuk disponoja një prokurë përfaqësimi për të. Kjo është arsyeja përse rezulton në emrin tim siguracioni i detyrueshëm.

*Më pas, me Kontratën e Shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.7.2010, të lidhur me kunatin tim, këtë automjet e kam blerë në vlerën 5.000 euro, të cilën e kam deklaruar edhe në DPV-në e vitit 2010.*

Në lidhje me çmimin e përcaktuar, për një automjet të vitit të prodhimit 2002, ky çmim përcakton një vlerë ireale, pasi dihet dhe është e qartë që automjeti është një send që amortizohet.

Në lidhje me dyshimet tuaja për sa i përket faktit që ky automjet nuk përdoret më prej meje, dua t'ju sqaroj se nuk është i vërtetë dhe as i saktë, pasi deformon provat, të cilat nuk bien në kundërshtim me faktet. Këtë automjet nuk e kam tjetërsuar në asnjë rast dhe vazhdoj ta përdor sa herë lind nevoja për ta përdorur atë për qëllimet e mia personale. Nuk mund të konkludohet që e kam shitur këtë automjet vetëm për faktin që te siguracioni i vitit 2019 figuron dhe emri i shtetasit S. M.. Unë kam qenë familjarisht në qytetin e Pukës deri në fund të muajit shtator 2019 dhe makina ime pësoi defekt që pengonte lëvizjen. Unë ia kam lënë makinën burrit të vajzës së xhaxhait tim S. M., i cili është shofer në profesion. Meqenëse ishte kosto e madhe që ta sillja makinën me karroatrec në Tiranë dhe defekti ishte mekanik, e lashë makinën në Pukë për disa ditë. Me riparimin e saj u mor pikërisht shtetasi S. M.. Pasi u riparua makina, S. më tha që kanë përfunduar dokumentet e makinës dhe unë i kërkova atij që t'i bënte të gjitha veprimet për të pasur dokumentacion të rregullt. S. M. ka shkruar edhe emrin e tij, pasi ai e solli automjetin nga qyteti i Pukës në Tiranë.

Në cilësinë e akteve shkresore që bënë fuqi të plotë provuese, ju vë në dispozicion kopjet e

dokumentacioneve të makinës, si Polica për Sigurimin e Detyrueshëm të mbajtjes së mjeteve motorrike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta, lidhur me shoqërinë ‘***’ sh. a., për automjetin me targa ‘***’, të periudhës së fundit të rinovimit, 2020- 2021, ku qartazi rezulton se është në pronësinë time. Nuk ka asnjë veprim juridik të tjetërsimit të këtij sendi dhe, rrjedhimisht, nuk ka se si të pretendohet që ky send është tjetërsuar nga unë”.

7.12 Shpjegimet e subjektit duken bindëse për Komisionin.

8. Nga hetimi ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit, në 7 vitet e fundit, **ka në përdorim automjetin tip ‘***’**, viti i prodhimit 2011, të cilin e përdor sipas Autorizimit³⁹ të lëshuar nga z. I. S. M.. Këtë autorizim, ai ia ka lëshuar për një periudhë të pacaktuar kohe subjektit të rivlerësimit për ta përdorur automjetin e tij brenda dhe jashtë shtetit.

8.1 DPSHTRr-ja⁴⁰ konfirmon se shtetasi I. S. M. ka blerë automjetin e mësipërm në Gjermani nga shoqëria ‘***’, në shumën 35.000 (tridhjetë e pesë mijë) euro, për të cilin ka paguar doganën në vlerën 828.600 (tetëqind e njëzet e tetë mijë e gjashtëqind) lekë dhe e ka pajisur me targën ***.

8.2 Shtetasi I. M. e ka blerë këtë automjet më 9.9.2014, në Gjermani, dhe nga verifikimi në sistemin *TIMS* rezulton se ai ka qenë jashtë shtetit në këto data. Nga një vështrim në sistemin *TIMS* rezulton se shtetasi I. M. del shpesh jashtë vendit me automjet, por nuk rezulton ta ketë përdorur automjetin me targa ***. Ai rezulton se përdor automjete të tjera.

8.3 Subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar përdorimin e këtij automjeti në asnjë DPV dhe as në deklaratën *Vetting*. Ai ka deklaruar përdorimin e automjetit në pyetësonin standard të dërguar nga Komisioni.

8.4 Nga verifikimi në sistemin *TIMS* rezulton se subjekti i rivlerësimit ka përdorur rregullisht automjetin me targa ***, që në datën 20.9.2014 në mënyrë të shpeshtë, megjithëse ndonjëherë (rallë) ka përdorur edhe automjetin në pronësi të tij me targa *** (e trajtuar më lartë).

8.5 Komisioni, duke marrë në konsideratë edhe praktikën e ndjekur nga Kolegji i Posaçëm i Apelit referuar vendimeve⁴¹ të tij, ku për çdo situatë të dyshuar se personat e tjerë të lidhur mund të mbajnë pasuri të fshehura të subjektit të rivlerësimit, nuk e kufizon Komisionin që të kryejë hetime për personat e tjerë të lidhur, i ka kërkuar shpjegime subjektit lidhur me marrëdhënien e tij me shtetasin z. I. M., duke e konsideruar këtë si person tjetër të lidhur, si dhe burimin e ligjshëm të të ardhurave të tij për blerjen e këtij automjeti, i cili duket se është përdorur rregullisht vetëm nga subjekti i rivlerësimit.

8.6 Subjekti i rivlerësimit shpjegon se ky automjet figuron në emër të shtetasit I. M., që është nipi i tij (djali i vajzës së xhaxhait), por ky automjet është pronë e shtetasit B. M., që është djali i z. Xh. M. (djali i xhaxhait të subjektit, me të cilin ka marrëdhënie të mirëfillta vëllazërore). Shtetasi Xh. M. dhe B. M. jetojnë familjarisht prej më shumë se 20 vjet në Mbretërinë e Bashkuar dhe meqë janë të pajisur me pasaporta angleze, kanë pengesë që të pajisen me targa të një automjeti në Republikën e Shqipërisë. Duke qenë se shtetasi B. M., në vitin 2014, dëshironte një automjet *fuoristradë*, që ta linte në Shqipëri dhe ta përdorte për periudhën që vinin familjarisht në Shqipëri, porositi shtetasin I. M. të blinte në Gjermani automjetin në fjalë dhe ta regjistronte në pronësi të vet. Kjo është arsyeja që ky automjet figuron në emër të shtetasit I.M.. Subjekti ka përcjellë edhe Deklaratën⁴² me shkrim nga z. B. M. dhe z. I. M., të cilët deklarojnë në lidhje me sa më sipër.

8.7 Subjekti i rivlerësimit⁴³, i pyetur nëse z. B. M. ka qenë fizikisht kur është blerë automjeti dhe si janë sjellë lekët për blerjen e tij në Shqipëri, subjekti sqaron se paratë, z. B. M., ia ka dërguar z. I. M. pjesërisht me bankë dhe pjesërisht *cash*. Ai ka shpjeguar se ky automjet është blerë në Gjermani dhe B. nuk ka qenë fizikisht në Gjermani në momentin e blerjes, por e ka përzgjedhur ai (B.) paraprakisht *online* në internet dhe më pas i ka kërkuar I. që të shkonte ta blinte. Subjekti shpjegon se ky automjet është përdorur vazhdimisht në Shqipëri nga B., babai i tij Xh. M., si dhe bashkëshorti i vajzës së Xh.. Ky automjet është mbajtur nga z. I. M. deri para dy vjetësh, kur ai është zhvendosur në Mbretërinë e Bashkuar, ku edhe banon aktualisht.

³⁹ Shihni Autorizimin nr. ***, datë 17.9.2014 për përdorim automjeti nga z. I. M. (përcjellë nga subjekti në listën e dokumenteve përgjigje pyetësorit datë 3.2.2020 dhe 7.2.2020).

⁴⁰ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 20.8.2020, nga DPSHTRr-ja.

⁴¹ Vendim nr. *** (JR), datë 21.10.2019, subjekti i rivlerësimit, z. ***; vendim nr. *** (JR), datë 17.7.2019, subjekti i rivlerësimit, z. ***.

⁴² Shihni deklaratën me shkrim nga z. B. M. dhe z. I. M. (përcjellë me përgjigjet e pyetësorit më 9.9.2020).

⁴³ Shihni përgjigjet e pyetësorit datë 9.9.2020 (pyetja 4).

8.8 Në lidhje me aftësinë financiare të shtetasve I. M. dhe B. M. për të blerë automjetin, subjekti ka përcjellë në Komision⁴⁴ kopje të llogarive bankare të z. B. M. në Mbretërinë e Bashkuar për periudhën gusht 2011 – dhjetor 2011 dhe kopje të vërtetimeve të llogaritjes së taksave për periudhën 2013 – 2015. Prej tyre rezulton se z. B. M. ka pasur të ardhura *neto* në vitin 2014, e cila përkon me periudhën kur është blerë automjeti (datë 9.9.2014) në vlerën totale 41.630 (dyzet e një mijë e gjashtëqind e tridhjetë) GBP. Me dokumentacionin e përcjellë në Komision deri në këtë moment nuk provohet aftësia financiare e shtetasve B. M. dhe I. M..

8.9 Referuar të dhënave të përfituara nga sistemi AMF subjekti i rivlerësimit rezulton si “përdorues” për këtë automjet (me targa ***), në policën e sigurimit të blerë në datën 16.9.2014 dhe pronar rezulton z. I. M..

8.10 Nga sistemi AMF, gjithashtu, rezulton se z. I. M. ka blerë polica sigurimi (TPL) edhe për automjetet e tjera, si vijojnë:

- a) Gjatë periudhës 24.3.2016 – 22.3.2019 rezulton pronar i automjetit tip “****”, viti i prodhimit 2011, me nr. shasie ***, me targa ***. Ky automjet rezulton i përdorur nga shtetasi I. M., sipas të dhënave në sistemin *TIMS*. Aktualisht, ky automjet rezulton i shitur te znj. R. M., e cila ka blerë policë sigurimi (TPL) për periudhën 26.3.2019 – 31.3.2020.
- b) Në periudhën 6.5.2015 – 5.5.2016 ka blerë policë sigurimi për një automjet tjetër tip “****”, viti i prodhimit 2007, me nr. shasie ***, me targa ***, për të cilin rezulton pronar. Ky automjet rezulton i përdorur nga shtetasi I. M., sipas të dhënave në sistemin *TIMS*. Ky automjet është shitur dhe aktualisht rezulton me pronar z. D. R., i cili ka blerë policë sigurimi për periudhën 21.6.2016 – 20.6.2017.
- c) Për periudhën 13.12.2011 – 15.12.2015, z. I. M. rezulton pronar i automjetit tip “****”, viti i prodhimit 2000, me nr. shasie ***, me targa ***. Ky automjet rezulton i përdorur nga shtetasi I. M., sipas të dhënave në sistemin *TIMS*.

8.11 Nga verifikimi në sistemin *TIMS* nuk rezulton se shtetasit B. M., babai i tij Xh. M., si dhe bashkëshorti i vajzës së Xh. të kenë përdorur ndonjëherë automjetin me targa ***, ndërkohë që rezulton se ata kanë ardhur shpesh në Shqipëri dhe kanë përdorur automjete të tjera. Po ashtu edhe shtetasi I. M. nuk rezulton të ketë përdorur këtë automjet.

8.12 Lidhur me pretendimin e subjektit se ky automjet është mbajtur nga z. I. M. deri para dy vjetësh, kur ai është zhvendosur në Mbretërinë e Bashkuar, ku edhe banon aktualisht, nga hetimi nuk rezulton që shtetasi I. M. të ketë përdorur automjetin me targa *** në asnjë nga daljet e tij në pikat kufitare dhe në asnjë rast, por rezulton se ai ka përdorur automjete të tjera. Po ashtu, nga sistemi *TIMS* rezulton se shtetasi I. M. vazhdon të vijë rregullisht në Shqipëri duke përdorur automjete të tjera dhe në një rast automjet me targa të huaja.

8.13 Subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion provues se cili është pronari i automjetit pasi shtetasi I. M. është zhvendosur në Mbretërinë e Bashkuar, por nga hetimi administrativ ka rezultuar se ky automjet vazhdon të përdoret rregullisht nga subjekti i rivlerësimit.

8.14 Në përfundim të hetimit për këtë pasuri ka rezultuar se:

- a) Subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar në DPV-të përkatëse zotërimin e automjetit *** me targa ***, të cilin e ka mbajtur sipas autorizimit për një periudhë të pacaktuar. Subjekti nuk ka deklaruar zotërimin e këtij automjeti në deklaratën *Vetting* dhe as të drejta reale që ka mbi këtë automjet, megjithëse duket se e ka përdorur në mënyrë të vazhdueshme dhe të qëndrueshme.
- b) Subjekti ka deklaruar se ky automjet është mbajtur nga z. I. M. deri para dy vjetësh (2018), por nga hetimi rezulton se ky automjet është përdorur vetëm nga subjekti i rivlerësimit, z. Shkëlqim Mustafa që në shtator të vitit 2009 e deri më sot në mënyrë konsistente dhe se nga të dhënat në sistemin *TIMS* nuk rezulton asnjë hyrje-dalje nga shtetasi I. M. apo B. M., të cilët duket se lëvizin me automjete të tjera.
- c) Pas hetimit mbi të dhënat e sistemit AMF rezulton se në të gjithë periudhën 2014 – mars 2019, z. I. M. ka pasur në pronësi automjete të tjera, të cilat rezultojnë edhe të përdorura prej tij në hyrje-daljet në sistemin *TIMS*.

⁴⁴ Shihni shkresat e përcjella dorazi me përgjigjet e datës 9.9.2020.

- ç) Subjekti nuk arrin të provojë me dokumentacion transfertën e të ardhurave nga z. B. M. drejt z. I. M., të cilat u përdorën për blerjen e automjetit. Gjithashtu, nuk arrihet të provohet se kjo pasuri është pronë e z. B. M. apo të jetë përdorur prej tyre në ndonjë rast.
- d) Subjekti nuk arrin të provojë aftësinë financiare të personave të lidhur (z. I. M. dhe z. B. M.) për të blerë automjetin e mësipërm në vlerën 35.000 (tridhjetë e pesë mijë) euro (kosto automjeti) plus 828.600 (tetëqind e njëzet e tetë mijë e gjashtëqind) lekë vlere e doganës, si dhe shpenzime të tjera të kryera.

dh) Komisioni nge dyshime se kjo është pasuri e subjektit të rivlerësimit, e padeklaruar prej tij.

8.15 Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar bindshëm lidhur me konstatimet e mësipërme dhe të paraqiste dokumentacion provues për të bindur Komisionin mbi të kundërtën e rezultateve të hetimit.

8.16 Në vijim të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit parashtroi: *“Juve keni konkluduar se ky automjet nuk është përdoruar nga pronari i tij, si dhe personat e sipërcituar. Ky konkluzion nuk është i saktë. Si B. M., Xh. M. dhe familjarët e tyre (fëmijët e tjerë, vajza apo dhëndri) e kanë përdorur këtë automjet gjithmonë sa herë kanë qëndruar në Shqipëri. Ata vijnë vazhdimisht dhe herë-herë në kohë të ndryshme dhe e përdorin këtë automjet për udhëtime në Shqipëri, kryesisht në zonat malore apo turistike që kanë rrugë të vështira. Përdorimi i një automjeti brenda territorit të Republikës së Shqipërisë nuk është një veprim që mund të lërë patjetër gjurmë në sistemin TIMS apo ndonjë pikë doganore.*

Po kështu, edhe shtetasi I. M. e ka përdorur këtë automjet dhe kjo provohet përveç të tjerave edhe me prova shkresore të administruara nga Komisioni. Kështu, sipas sistemit TIMS provohet qartësisht se I. M. ka kaluar në pikat doganore të Republikës së Shqipërisë në datat: 6.6.2017; 21.8.2017; 16.9.2016; 15.2.2015; 18.8.2017 dhe 30.5.2017.

*Në lidhje me mosdeklarimin tim të faktit të përdorimit të automjetit, i sqaroj trupit gjykues që ky fakt është pasqyruar dhe pohuar prej meje përgjatë hetimit administrativ, kam qenë i sigurtë dhe transparent. Unë nuk jam dhe as kam qenë ndonjë pronar i atij automjeti dhe ndoshta përgjatë deklaramëve të mia vjetore, si dhe në deklaratën Vetting kam vlerësuar si të domosdoshëm të pasqyroj ato pasuri që janë vetëm në pronësinë time, sikundër është automjeti ‘***’, i blerë nga kunati im K. F..*

Edhe pse ekziston kjo mungesë e pasqyrimin të deklaramit të përdorimit të një automjeti në deklaratën periodike vjetore, nuk mund të vlerësohet në asnjë rast si fshehje e pasurisë së subjektit pasi e theksoj edhe njëherë, ky automjet nuk është në pronësinë time.”

8.17 Trupi gjykues, në përfundim të vlerësimit lidhur me këtë pasuri, bazuar në faktet dhe provat e rezultuara gjatë hetimit, si dhe në bindjen e brendshme të tij, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e germës “c”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, duke e fshehur këtë pasuri në deklaratën Vetting.

9. Subjekti, në lidhje me adresat e banimit dhe gjendjen civile, në deklaramet periodike vjetore deklaroi se deri në vitin 2008 ka jetuar në banesën me vendndodhje lagjen “***”, Gjirokastër. Më pas, në DPV-në e vitit: 2009 nuk deklaroi adresë banimi; 2010 deklaroi “s’ka ndryshim”; 2011 nuk deklaroi adresë banimi as vend tjetër qëndrimi; 2012 nuk deklaroi adresë banimi as vend tjetër qëndrimi; 2013 nuk deklaroi adresë banimi as vend tjetër qëndrimi. Në DPV-në e vitit 2014 – 2015 deklaroi si adresë ku janë regjistruar në gjendjen civile: Rr. “***” Tiranë, nuk deklaroi vend tjetër qëndrimi. Në DPV-në e vitit 2016 nuk deklaroi adresë ku janë regjistruar në gjendjen civile as vend tjetër qëndrimi; në deklaratën Vetting subjekti deklaroi në rubrikën “nëse dispononi vend tjetër qëndrimi”, Rr. “***” Tiranë.

9.1 Subjekti i rivlerësimit, i pyetur nga Komisioni gjatë hetimit⁴⁵, deklaroi se:

- a) *“... në periudhën 2003 – 2005 kam banuar te shtëpia e prindërve të bashkëshortes në Gjirokastër;*
- b) *në periudhën 2006 – 14.4.2010 kam banuar në shtëpinë, në lagjen ‘***’, në Gjirokastër;*
- c) *në periudhën 15.4.2010 – 18.11.2012 kam banuar në shtëpinë e vëllait në Durrës, në Rr. ‘***’;*
- ç) *në periudhën 19.11.2012 deri në Vetting kam banuar në shtëpinë, në Tiranë, në Rr. ‘***’.*

⁴⁵ Shihni përgjigjet e pyetësorit datë 15.2.2019 (pyetja 1).

9.2 Subjekti shpjegon⁴⁶ se në periudhën 11.9.1995 – 26.9.1998, periudhë kur ka qenë i emëruar si prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjirokastër, ka banuar në Shtëpinë Ushtarake Gjirokastër, ku pagesa ka qenë rreth 3.800 (tre mijë e tetëqind) lekë/muaj. Nga data 26.9.1998 deri në shtator të vitit 2006, subjekti deklaroi se ka banuar në shtëpinë e prindërve të bashkëshortes, sepse ata banonin në Athinë, Greqi, së bashku me kunatin e subjektit. Më tej, prej shtatorit të vitit 2006 deri në prill të vitit 2010, ai ka banuar në banesën e tij (apartament me sip. 88.8 m²), në Gjirokastër dhe prej prillit të vitit 2010 deri në nëntor të vitit 2012, ai ka banuar në banesën e vëllait të tij, z. A. M., në Rr. “***”, Durrës. Së fundmi, prej nëntorit të vitit 2012 e në vazhdim subjekti ka banuar në apartamentin e banimit në Rr. “***”, Tiranë.

9.3 Subjekti, i pyetur⁴⁷ nga Komisioni nëse ka banuar së bashku me vëllain e tij në Durrës dhe se sa është vlera totale e banesës, sqaron se ka banuar në një banesë me vëllain e tij A. M. për periudhën prill 2010 – nëntor 2012 dhe ky ka qenë momenti i parë në jetën e tij që ka banuar me vëllain. Banesa në Durrës ka filluar të ndërtohet në vitin 1996 dhe ka vazhduar ndër vite. Në vitin 2009, vëllai i tij ka marrë një kredi dhe bashkë me të ardhurat e fëmijëve të tij ka ndërtuar edhe katin e dytë të banesës, e cila është aplikuar për legalizim në vitin 2005, kur ishte ndërtuar kati i parë. Pasi është ndërtuar edhe kati i dytë është aplikuar për legalizim si banesë dykatëshe. Aktualisht, kjo banesë ndodhet në proces legalizimi, pasi për shkaqe ekonomike nuk është vazhduar më tej kjo procedurë. Subjekti thekson se nuk ka asnjë lidhje me këtë banesë, por ka qëndruar për një periudhë kohe në shtëpinë e vëllait të tij meqenëse kishte hapësira të mjaftueshme. Në lidhje me përcaktimin e vlerës totale të banesës, subjekti sqaron se nuk mund të përcaktojë dot një vlerë totale, për shkak se është bërë një investim gradual familjar. Gjithashtu, subjekti thekson se vëllai i tij i ndjerë A. M. dhe trashëgimtarët e tij (bashkëshortja dhe fëmijët) nuk kanë pasur dhe nuk kanë asnjë pasuri tjetër të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë. Subjekti bashkëngjit procesverbalet e dosjes së ALUIZNI-t për banesën e vëllait të tij A. M. (e cila rezultoi ende në proces legalizimi).

9.4 Nga dosja e administruar prej DRSHTRR-së rezultoi se subjekti ka paraqitur një kërkesë në datën 14.1.2011 në DRSHTRR Tiranë (kërkesa nr. *** prot.) me anë të së cilës kërkon transferimin e dosjes së automjetit nga Gjirokastra në Tiranë pasi ka vendbanimin në Tiranë sipas vërtetimit nr. ***, datë 12.1.2011.

9.5 Nga dokumenti Deklaratë Noteriale i përpiluar para noterit në datën 29.3.2011, z. Shkëlqim Mustafa deklaroi se është banues në Tiranë, në rrugën “***”, banesa nr. ***.

9.6 Nga informacioni i marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ka rezultuar se shtetasi Shkëlqim Mustafa dhe bashkëshortja e tij figurojnë të regjistruar nga data 12.1.2011 si banorë në Njësinë Bashkiake nr. ***, Njësia Administrative Tiranë, Bashkia Tiranë, me adresë vendbanimi: Rr. “***”, nr. 48, Tiranë.

9.7 Në përfundim të hetimit rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë dhe me transparencë adresat e banimit ndër vite, duke i fshehur ato.

9.8 Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të shpjeguar bindshëm për Komisionin shkaqet e mosdeklarimeve të adresave të banimit ndër vite, në kuptim të ligjit nr. nr. 9049/2003, i ndryshuar, i cili ka parashikuar detyrimin e subjekteve deklaruese, lidhur me mënyrën se si duhen deklaruar adresat e saktë e gjendjes civile të subjekteve, si dhe adresat e plotë të banimit apo nëse disponohen vendqëndrime të tjera duhen deklaruar adresat e sakta të tyre. Komisioni i kërkoi subjektit të shpjegonte lidhur me adresën e banimit të deklaruara në gjendjen civile në janar të vitit 2011, në rrugën “***”, nr. ***, Tiranë.

9.9 Në vijim të rezultateve të hetimit subjekti ka shpjeguar: *“Në lidhje me konstatimet për mosdeklarimin e adresave të vendbanimit, ky fakt nuk është i vërtetë, pasi nuk ka qenë qëllimi im mosdeklarimi i qëllimshëm i adresave të vendbanimit. Ideja ime mbi vendbanimin lidhej vetëm me kuptimin e regjistrimit të të dhënave të gjendjes civile, pranë Gjendjes Civile ku unë kisha të regjistruara gjeneralitetet e mia.*

Theksoj sërish se pasaktësitë për sa i përket deklarimit të vendbanimit tim për këtë periudhë, nuk janë në asnjë rast të qëllimshme, nuk përbëjnë fakte të rreme për sa kohë janë zyrtarisht të

⁴⁶ Shihni përgjigjet e pyetësorit datë 3.2.2020 (pyetja 7).

⁴⁷ Shihni përgjigjen nr. 1, te pyetësori i datës 9.9.2020.

verifikueshme, ndaj dhe Komisioni nuk duhet të vlerësojë këtë sjellje si një sjellje e cila kualifikohet si një rast i dhënies së një mase disiplinore kundrejt subjektit”.

9.10 Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar adresat e sakta të banimit në deklaratimet periodike vjetore, por e ka deklaruar saktë atë në deklaratën *Vetting*. Pasaktësitë e konstatuara në DPV lidhur me adresat e banimit dhe vendndodhjen e subjektit të rivlerësimit duhet të ishin objekt vlerësimi nga ILDKPKI-ja.

10. Analiza financiare e viteve 2003 – 2016

10.1 Shpenzimet për udhëtime jashtë shtetit u analizuan bazuar në të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë⁴⁸, konkretisht, lëvizjet hyrëse–dalëse nëpërmjet sistemit *TIMS* të subjektit të rivlerësimit dhe familjarëve, si dhe u krahasuan me deklaratimet e subjektit⁴⁹. Për përlllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit janë marrë si referencë deklaratimet e subjektit mbi kostot e shpenzuara për secilin udhëtim, vendimi nr. 11/2019 (JR), datë 22.5.2019, i KPA-së, si dhe deklaratimet e subjektit. Nuk janë marrë në konsideratë shpenzimet e udhëtimit kur subjekti ka deklaruar udhëtime për qëllime pune⁵⁰, të cilat janë provuar me dokumentacion. Gjithashtu, nuk janë konsideruar shpenzimet e akomodimit për rastet kur subjekti ka deklaruar se është akomoduar te të afërmit dhe e ka provuar me dokumentacion deklarimin e tij. Në rastet e tjera kur deklaratimet e subjektit kanë qenë të pambështetura në dokumentacion provues, shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit janë konsideruar mbi bazën e vendimit nr. 11/2019 (JR), datë 22.5.2019, të KPA-së.

10.2 Shpenzimet e arredimit⁵¹ u bazuan në deklaratimet e subjektit për shpenzimet e apartamentit, megjithëse u konsideruan nga Komisioni, modeste dhe në vlerë të ulët.

10.3 Subjekti nuk deklaroi kursime *cash*, për të gjithë periudhën e deklarimit (2003 – 2016).

10.4 Në vitin 2010, subjekti i rivlerësimit me të ardhurat e realizuara nga pagat dhe nga shitja e apartamentit ka pasur mundësi financiare për shlyerjen e kredisë bankare, kryerjen e shpenzimeve të llogaritura nga Komisioni dhe për të kursyer shumën 38.000 (tridhjetë e tetë mijë) euro (të cilat i ka dhënë hua sipas deklaratës datë 29.3.2011), duke rezultuar me një bilanc pozitiv.

10.5 Në konkludim të sa më sipër, Komisioni vlerëson se huaja është dhënë në vitin 2010, siç citohet në deklaratën noteriale të kryer në mars të vitit 2011. Huaja është deklaruar në DPV-në e vitit 2010, duke përfshirë edhe deklaratën noteriale të vitit 2011 me arsyetimin se ajo është përpiluar para dorëzimit të deklaratës periodike vjetore të vitit 2010, e duke e konsideruar këtë si një lapsus.

10.6 Në vijim të rezultateve të hetimit, duke pranuar faktet sa më sipër si dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me disa shpenzime mbi pagimin e interesave të kredisë në vitin 2008, shpenzime për udhëtime në Janinë me periudhë qëndrimi pak orë, të cilat nuk duhet të llogariten si shpenzim⁵², analiza financiare rezulton me balancë negative në vlerën -258.103 (dyqind e pesëdhjetë tetë mijë e njëqind e tre) lekë në vitin 2008 dhe në shumën -467.377 (katërqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e treqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë në vitin 2014.

10.7 Referuar shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, kjo situatë negative financiare ka ardhur sepse në këto vite, megjithëse bashkëshortja e tij ka punuar, nuk dispononin dokumentacion ligjor e financiar.

10.8 Në përfundim, trupi gjykues pranoi shpjegimet e subjektit, si dhe administroi dokumentacionin përkatës duke konkluduar se ai gjendet në një situatë negative financiare në vlerën -752.488 (shtatëqind e pesëdhjetë e dy mijë e katërqind e tetëdhjetë e tetë) lekë, duke mbajtur në konsideratë në analizën financiare të kryer nga Komisioni për vitet 2003 – 2016 vlerën e paguar për apartamentin në shumën 28.000 (njëzet e tetë mijë) euro, si dhe pa evidentuar ndonjë detyrim ndaj subjektit të rivlerësimit.

10.9 Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, pasi ai rezultoi me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet e kryera ndër vite.

⁴⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 20.9.2019.

⁴⁹ Përgjigjet e pyetësorit datë 15.2.2019 dhe përgjigjet e pyetësorit datë 10.8.2020.

⁵⁰ Pyetësori i datës 15.2.2019 dhe pyetësori i datës 3.9.2020.

⁵¹ Pyetësori datë 15.2.2019.

⁵² Vendimi nr. 11/2019 (JR), datë 22.5.2019, i KPA-së.

16. Konkluzione për rubrikën e vlerësimit të pasurisë

Nga kontrolli i pasurisë ndaj subjektit të rivlerësimit u evidentuan problematika lidhur me vlerësimin e pasurisë, nga ku rezultoi se ai ka kryer deklarim të pasaktë e të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016 dhe se ai nuk ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë së tij.

B. KONTROLLI I FIGURËS

17. DSIK-ja ka dërguar raportin mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, më 30.10.2017 në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016. Ky raport është deklasifikuar plotësisht me vendim nr. ***, datë 24.1.2019, të KDZH-së. Raporti, në përfundim, konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Shkëlqim Mustafa.

18. Komisioni i kërkoi informacion Prokurorisë së Përgjithshme⁵³ mbi të dhëna ose *indicie* nga agjencitë ligjzbatuese për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshimet e ngritura në kuptimin penal dhe atë të cenimit të figurës së subjektit të rivlerësimit, të përfshirë drejtpërdrejtë në veprime të dyshimta, si dhe informacione mbi kontakte të papërshtatshme.

19. Prokuroria e Përgjithshme (sektori i protokollit dhe arkivit)⁵⁴ sqaron se nga kontrolli i ushtruar në Regjistrat e Kallëzimeve dhe Procedimeve Penale të Prokurorisë së Përgjithshme, nuk rezulton të ketë çështje penale apo kallëzim penal të filluar ndaj subjektit të rivlerësimit.

20. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës⁵⁵ informoi se nga verifikimi i kryer në zyrën e regjistrat në këtë Prokurori, për periudhën kohore 1.1.2006 – 7.3.2019 rezultoi se ndaj subjektit të rivlerësimit është regjistruar procedimi penal nr. ***, datë 11.4.2018, për veprën penale “shpërdorim detyre”, për të cilin është marrë vendimi i transferimit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 25.4.2018. Më tej, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë⁵⁶ informon se nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të kallëzimeve dhe procedimeve penale për periudhën kohore 1.1.2009 – 26.6.2019 nuk rezultoi që, ndaj subjektit të rivlerësimit të jetë regjistruar kallëzim, procedim penal apo disiplinor në ngarkim të tij.

21. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë⁵⁷ informon se ndaj subjektit është regjistruar kallëzimi penal me nr. ***, datë 11.12.2018, në lidhje me veprat penale “korrupsion pasiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë” dhe “shpërdorim detyre”, parashikuar nga nenet 319/ç dhe 248 të Kodit Penal. Pas verifikimeve të kryera datë 26.12.2018, prokurori i çështjes ka vendosur të mos fillojë procedimin penal.

22. Komisioni, me shkresën nr. *** prot., datë 11.8.2020 i ka kërkuar informacion institucioneve ligjzbatuese nëse disponojnë informacion të rifreskuar për subjektin e rivlerësimit, z. Shkëlqim Mustafa, si dhe është kërkuar rifreskim i raportit dërguar më 30.10.2017, lidhur me vlerësimin e figurës nga DSIK-ja.

23. Konstatimet e mbledhura nuk krijojnë të dhëna për kontakte të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit dhe as ndryshime të raportit nga institucionet përgjegjëse. Dyshimet e rezultuara gjatë verifikimit se subjekti i rivlerësimit mund të jetë i përfshirë në korrupsion pasiv, Komisioni i hetoi dhe vlerësoi në kuadër të procesit të rivlerësimit të subjektit dhe rëndësisë së integritetit të figurës së gjyqtarit si një kriter vlerësimi për subjektet e rivlerësimit në kuptim të ligjit nr. 84/2016.

24. Konkluzione për rubrikën e vlerësimit të figurës

Trupi gjykues, pasi shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit, deklaratën për kontrollin e figurës, raportin e DSIK-së, informacionet nga organet ligjzbatuese, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi. Nuk u provua që subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo që të jetë i përfshirë, apo i vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, si rrjedhojë e gjen atë të përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

⁵³ Shkresën nr. ***, datë 22.2.2019.

⁵⁴ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 11.3.2019, nga Prokuroria e Përgjithshme (Sektori i Protokollit dhe Arkivit), në dosjen e Komisionit.

⁵⁵ Shihni shkresën nr. ***prot., datë 7.3.2019, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në dosjen e Komisionit.

⁵⁶ Referojuni shkresës nr. ***prot., datë 26.6.2019, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në dosjen e Komisionit.

⁵⁷ Referojuni shkresës nr. ***prot., datë 9.10.2019, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor për Krimet e Rënda Tiranë.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

25. Ky raport profesional është përgatitur bazuar në raportin e sjellë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, denoncimet e paraqitura në Komision, si dhe gjetjet e evidentuara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ.

26. Këshilli i Lartë Gjyqësor, si organi ndihmës për vlerësimin profesional të subjekteve, dërgoi raportin profesional për subjektin e rivlerësimit, bazuar në tri dokumente ligjore, të llojit vendim gjyqësor të viteve 2014, 2015 dhe 2016, si dhe pesë dosje të përzgjedhura me short.

27. Në analizë të përbashkët të dosjeve të vlerësuar nga KLGj-ja ka rezultuar se në përgjithësi, subjekti i rivlerësimit, z. Shkëlqim Mustafa, vlerësohet i aftë në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Ai ka aftësi në arsyetimin ligjor të vendimeve, duke respektuar rregullat e drejtshkrimit. Nga vlerësimi i dosjeve ka rezultuar se vendimet e ndërmjetme, përgjithësisht, nuk arsyetohen ose kanë arsyetim minimal dhe nuk kanë referenca ligjore. Në një rast është marrë vendimi për caktimin e një avokati kryesisht, në një kohë që në seancën e mëparshme ishte marrë vendimi për caktimin e një avokati tjetër dhe nuk ka vendim për revokimin e vendimit. Niveli i arsyetimit të vendimeve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Në 8 rastet e vëzhguara rezulton se vetëm ndaj 2 vendimeve është ushtruar e drejta e rekursit dhe për një rast Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit (shihni dosjen 1) dhe në rastin tjetër nuk mund të nxirren konkluzione pasi Gjykata e Lartë nuk është shprehur ende mbi rekursin (shihni dosjen 2).

DENONCIMET E PUBLIKUT

28. Në Komision janë shqyrtuar 22 denoncime ndaj subjektit të rivlerësimit, z. Shkëlqim Mustafa. Pas vlerësimit nga Komisioni rezultuan se një pjesë e denoncimeve nuk lidhen me subjektin e rivlerësimit. Disa denoncime rezultuan se lidhen me mënyrën e gjykimit të themelit të çështjes nga subjekti i rivlerësimit, apo nuk përmbanin fakte e rrethana që mund të përbënin provë në lidhje me kriterin e vlerësimit profesional të subjektit të rivlerësimit.

29. Disa prej denoncime u vlerësuan nga Komisioni dhe iu kërkuan shpjegime subjektit të rivlerësimit.

29.1 Denoncimi i shtetasit N. L.⁵⁸. Objekti i denoncimit: denoncon për zvarritje të gjykimit. Mes të tjerash, denoncuesi bashkëngjiti edhe vendimin nr. ***, datë 26.7.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku kryesues në trupin gjykues është subjekti i rivlerësimit.

Denoncuesi është babai i viktimës V. L., e cila ka ndërruar jetë në një aksident rrugor të ndodhur në autostradën Tiranë-Durrës. Çështja gjyqësore ka të bëjë me të pandehurin A. N., i akuzuar për veprën penale “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor” me pasojë vdekjen, të parashikuar nga neni 290/1 i Kodit Penal.

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka regjistruar procedimin penal nr. ***, datë 30.5.2006, që bën fjalë për veprën penale “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, të parashikuar nga neni 290/1 i Kodit Penal, në ngarkim të të pandehurit A. N.. Në përfundim të hetimeve, Prokuroria ka konkluduar se nuk formoheshin të gjitha elementet e veprës penale dhe në datën 4.8.2006 ka vendosur pushimin e gjykimit për këtë procedim penal, bazuar në germën “dh”, të nenit 328/1, të Kodit të Procedurës Penale.

Mbi bazën e ankimit të nënës së viktimës shtetases M. L., me vendimin nr. *** Akti, datë 8.2.2008, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur “Prishjen e vendimit të procedimit penal nr. 1896, të vitit 2006 dhe vazhdimin e mëtejshëm të hetimeve ...”.

Pas kryerjes së detyrave të urdhëruara nga gjykata, në datën 3.9.2008, nga Prokuroria Tiranë është vendosur përsëri pushimi i hetimeve për procedimin penal.

Mbi bazën e ankimit të nënës dhe babait të viktimës, me vendimin nr. *** Akti, datë 28.1.2009, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur “Prishjen e vendimit të pushimit të procedimit penal dhe vazhdimin e mëtejshëm të hetimeve ...”.

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vazhduar hetimet për këtë procedim dhe në përfundim të hetimeve në datën 24.9.2010 ka vendosur “dërgimin për gjykim të çështjes penale në ngarkim të të pandehurit A. N.”.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 26.7.2012, ka vendosur deklarinimin fajtor të të pandehurit A. N. për veprën penale “shkelje e rregullave të qarkullimit

⁵⁸ Denoncim nr. *** prot., datë 24.11.2017, nga z. N. L..

rrugor, me pasojë vdekjen dhe në bazë të neneve 290/1 dhe 49 të Kodit Penal, dënimin e tij me 1 vit e 6 muaj burgim” dhe në aplikim të nenit 37 të Kodit Penal caktimin e dënimit plotësues “Ndalimin për të drejtuar automjete për një periudhë 2-vjeçare”.

29.1.1 Sa më sipër, Komisioni i kërkoj subjektit të paraqesë shpjegime lidhur me faktorët që kanë ndikuar në zvarritjen e gjykimit të çështjes me gati dy vjet.

29.1.2 Subjekti shpjegon: *“Lidhur me këtë denoncim sqaroj se shkaqet e shtyrjes së seancave kanë qenë ligjore, siç mund të jetë mungesa e prokurorit, të pandehurit apo mbrojtësit të tij, etj. Seancat janë shtyrë brenda afatit ligjor dhe relatori i çështjes nuk është bërë shkak për shtyrjen e seancave. Në mbështetje të pretendimeve të mësipërme ju paraqes gjithë fotokopjen e dosjes gjyqësore të nxjerrë nga arkiva e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”.*

29.2 Denoncimi i shtetasit Xh. C.⁵⁹. Objekti i denoncimit: denoncon për dhënie vendimi të padrejtë.

Prokuroria ka kryer regjistrimin e procedimit penal për aksidentin me pasojë vdekjen (humbjen e jetës së znj. L. C. në një aksident rrugor. Në përfundim të hetimeve, Prokuroria ka vendosur pushimin e procedimit penal dhe denoncuesi ka nisur procedurën e ankimit.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë dhe më pas Gjykata e Apelit Tiranë kanë lënë në fuqi vendimin e Prokurorisë. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë. Gjykimi në Gjykatën e Apelit Tiranë është kryesuar nga subjekti i rivlerësimit. Denoncimi ka bashkëngjitur edhe vendimin nr. ***, datë 22.5.2018, të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Denoncuesi pretendon se çështja gjyqësore është shqyrtuar në dhomë këshillimi, pa praninë e palëve, ndërsa në vendim pasqyrohet se seanca ka qenë gjyqësore, gjë që nënkupton me palë prezente, por që në fund në dispozitiv Gjykata e Apelit Tiranë urdhëron që “ky vendim t’u komunikohet palëve”. Në vendim nuk parashikohet e drejta e ankimimit.

29.2.1 Komisioni i kërkoj subjektit të paraqesë procesverbalin e çështjes gjyqësore për të provuar nëse çështja gjyqësore është shqyrtuar në dhomë këshillimi, pa praninë e palëve, siç pretendon denoncuesi apo është zhvilluar si seancë gjyqësore, siç është përcaktuar në vendim.

29.2.2 Subjekti shpjegon: *“Lidhur me këtë denoncim sqaroj se ai është i papranueshëm për shqyrtim nga ana e KPK-së, për këto arsye:*

*Me vendimin nr. ***, datë 23.5.2018, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur: ‘Lënien në fuqi të vendimit nr. *** Akti, datë 29.3.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë’. Ankuesja L. L. në këtë çështje ka pasur cilësinë e kallëzueses. Sipas Kodit të Procedurës Penale vendimi i Gjykatës së Apelit është vendim i formës së prerë. Ndodhur në këto kushte, për efekt të vlerësimit të këtij vendimi duhet të mbahet parasysh vendimi nr. 29, datë 30.4.2001, i Gjykatës Kushtetuese. Nga përmbajtja e këtij vendimi theksohet se organi i procedimit disiplinor nuk mund të bëjë vlerësimin e ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve gjyqësore, aq më tepër kur ato kanë marrë formë të prerë, pasi kontrolli i vendimeve gjyqësore mbi interpretimin e ligjit material e procedural mund të bëhet vetëm nga një gjykatë më e lartë.*

- *Periudha e rivlerësimit kalimtar për komponentin profesional përfshin si rregull periudhën 8.10.2013 – 8.10.2016 dhe, si përjashtim, nga rregulli periudhën nga data 1.1.2006 deri më 8.10.2016. Pas kësaj periudhe, në respektim të neneve 3, pika 2, 41 të ligjit nr. 84/2016, të nenit 171 të ligjit nr. 96/2016, si dhe neneve 4 dhe 7 të Kushtetutës së Shqipërisë, kompetencë ekskluzive për të bërë inspektimin e shkeljeve disiplinore dhe vlerësimin etik e profesional të magistratëve e ka Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë.*

- *Për sa i përket denoncimit dua t’ju bëj me dije se në çështjen e mësipërme ku unë kam qenë në cilësinë e anëtarit të çështjes, në përputhje me nenin 329 të Kodit të Procedurës Penale këto lloj çështjesh gjykohen nga Gjykata e Apelit në dhomë këshillimi brenda 15 ditëve nga momenti i regjistrimit të akteve në Gjykatën e Apelit. Në rastin konkret vlerësoj se nuk qëndrojnë pretendimet e ngritura në denoncim dhe gjykata ka vepruar në përputhje me ligjin, pasi në rastin konkret është provuar pa asnjë ekuivok se ndodhemi para një marrëdhënieje juridiko – civile dhe jo para veprimeve me trajtë kriminale që të konturojnë elementet e veprës penale të parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal”.*

⁵⁹ Denoncim nr. *** prot., datë 17.7.2018, nga z. Xh. C..

29.3 Denoncim nga shtetasi S. M.⁶⁰. Objekti i denoncimit: denoncon për gjykim të padrejtë. Denoncuesi pretendon se në përfundim të gjykimit të çështjes, trupi gjykues me anëtar subjektin e rivlerësimit kanë nxjerrë vendimin nr. ***, datë 2.11.2015, të Gjykatës së Apelit Tiranë. Ai pretendon se ka konstatuar ndjenjën e urrejtjes nga trupi gjykues ndaj tij dhe familjes së tij, si ish i burgosur politik (është diskriminuar për shkak të përkatësisë me një grup të veçantë njerëzish).

29.3.1 Komisioni i ka kërkuar subjektit të paraqesë shpjegime, si dhe procesverbalin e çështjes gjyqësore lidhur me ecurinë e çështjes gjyqësore.

29.3.2 Subjekti shpjegon: *“Lidhur me denoncimin dua t’ju sqaroj se çështja është gjykuar në përputhje me ndryshimet ligjore të bëra në vitin 2017, në dhomë këshillimi, ky fakt provohet nga shpallja e afishuar në faqen e internetit të Gjykatës së Apelit Tiranë, në stendën publike të gjykatës, si dhe në letërthirrjen drejtuar kërkuesit. Fakti që në kokën e vendimit është shkruar senacë gjyqësore është një lapsus. Në vijim të vendimit, pas parashtrimeve të shkaqeve të ankimit pershkruhet: ‘Gjykata e Apelit Tiranë pasi shqyrtoi shkaqet e ankimit, në dhomë këshillimi vëren’. Edhe fakti që është disponuar për komunikimin e vendimit palëve, tregon se ky gjykim është bërë në dhomë këshillimi. Po kështu, edhe procesverbali gjyqësor tregon qartë se kjo çështje është gjykuar në dhomë këshillimi.*

Kërkuesi e ka ushtruar të drejtën e rekursit sipas ligjit në Gjykatën e Lartë dhe çështja është ende në pritje për t’u shqyrtuar nga Gjykata e Lartë. Në mbështetje të pretendimeve të mësipërme ju paraqes procesverbalin e seancës mbajtur në dhomë këshillimi, njoftimi i bërë në faqen e internetit, si dhe printimin nga faqja e internetit të Gjykatës së Lartë që tregon se çështja është ende në pritje për t’u gjykuar”.

29.4 Komisioni, nga disa informacione mediatike⁶¹ është informuar sa vijon: *“Shtetasi I. M., B. K., F. SH. janë të dëmtuar financiarisht nga F. S., i cili po vuan dënimin me 10 vjet burgim të dhënë nga Gjykata e Tiranës për ‘Mashttrim me pasoja të rënda’. F. S. është dënuar nga shkalla e parë në vitin 2017, pasi Prokuroria e Tiranës provoi se ai kishte mashtruar disa persona, me një vlerë rreth 1 milion euro.”*

Çështja e tij tashmë pritet të shqyrtohet në Gjykatën e Apelit, prej trupës së përbërë nga V. H., Shkëlqim Mustafa dhe G. Sh.. Krahas kallëzimit penal, i dëmtuari I. M. ka dorëzuar edhe një kërkesë për përjashtimin e trupës gjykuese të Apelit, me argumentin se ekzistojnë dyshime se ata mund të jenë të njëanshëm në çështjen kundër F. S., e përfaqësuar në gjykatë nga prokurorja A. M.. Për më tepër, njëri prej gjyqtarëve për të cilët kërkohet përjashtimi, Shkëlqim Mustafa, rezulton të ketë qenë pjesë e trupës gjykuese në një proces të mëparshëm, ku i kallëzuar aktual për ‘Kanosje’, shtetasi I. A., është shpallur i pafajshëm në Gjykatën e Apelit, pasi më herët Gjykata e Shkallës së Parë e kishte dënuar me 12 vjet burgim për ‘Mashttrim’”.

29.4.1 Komisioni, i është drejtuar Gjykatës së Apelit Tiranë me shkresën nr. *** prot., datë 1.10.2020, duke kërkuar informacion dhe dokumentacion në lidhje me çështjen penale me të pandehur z. F. S.. Gjykata e Apelit Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 6.10.2020, ka vënë në dispozicion informacionin e kërkuar nga verifikimi i të cilit rezulton se:

- Gjykata e Apelit Tiranë, në datën 20.7.2020, ka filluar shqyrtimin e gjykimit me të pandehur z. F. S., ku në përbërjen e trupit gjykues ka qenë edhe subjekti i rivlerësimit.
- Në datën 21.9.2020 viktima e veprës penale ka paraqitur kërkesën për përjashtimin e trupës gjykuese duke parashtruar se i lindin dyshime për paanshmërinë e saj.
- Në datën 25.9.2020 kjo kërkesë nuk është pranuar nga Gjykata e Apelit Tiranë.
- Në datën 5.10.2020 subjekti ka paraqitur kërkesën për heqje dorë nga gjykimi i çështjes duke parashtruar se *“pretendimet e viktimës nuk qëndrojnë, në një vlerësim të tij mund të jenë sajesa për ta goditur në fazën në të cilën ndodhet në procesin e Vetting-ut.”*

29.4.2 Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të paraqesë shpjegime lidhur me: (a) pretendimet e ngritura në denoncim, konkretisht: *“... njëri prej gjyqtarëve për të cilët kërkohet përjashtimi, Shkëlqim Mustafa, rezulton të ketë qenë pjesë e trupës gjykuese në një proces të*

⁶⁰ Denoncim nr. *** prot., datë 13.8.2018; denoncim nr. *** prot., datë 13.8.2018; denoncim nr. *** prot., datë 13.8.2018 dhe denoncim nr. *** prot., datë 25.9.2019, nga z. S. M..

⁶¹ https://boldneës.al/2020/09/29/i-demtuar-nga-mashtrimi-1-mln-dollare-kallezon-tentative-korrupsioni-ne-gjykatene-apelittirane/?fbclid=IÉARIÉ2Ka63DrlYRIA_3EÉjrGGD9ICXi_-cfE5LTpè4EAGLU6QènXgXRTèx58

mëparshëm, ku i kallëzuar aktual për 'Kanosje', shtetasi I. A., është shpallur i pafajshëm në Gjykatën e Apelit, pasi më herët Gjykata e Shkallës së Parë e kishte dënuar me 12 vjet burgim për 'Mashtrim' për pjesëmarrjen tuaj në këtë proces në kushtet e konfliktit të interesit.”; (b) Shkaqet për pranimin e dorëheqjes, të cilat ndryshuan në një hark kohor prej rreth 10 ditësh.

29.4.3 Subjekti shpjegon: “... Seanca e parë ku ka qenë i pranishëm i dëmtuari I. M. ka qenë pikërisht në datën 14.9.2020, ku ky i fundit nuk ka shfaqur ndonjë pretendim në lidhje me mua dhe anëtarin tjetër të trupit gjykues (pasi kryesuesja nuk ishte në gjykatë atë ditë). Seanca e ardhshme është caktuar në datën 5.10.2020.

Pas seancës së datës 14.9.2020, pikërisht datë 21.9.2020 viktimja e veprës penale ka paraqitur kërkesë për përjashtimin e trupit gjykues. Unë si anëtar i trupit gjykues nuk jam njohur me kërkesën për përjashtim. Me këtë kërkesë, si dhe me mënyrën e disponimit të saj nga një tjetër trup gjykues, unë gjyqtari Shkëlqim Mustafa dhe gjyqtari G. Sh. jemi njohur vetëm në seancën e datës 5.10.2020.

Në harkun kohor të dy seancave gjyqësore, pikërisht asaj të datës 14.9.2020 deri në atë të datës 5.10.2020 janë bërë dy shkrime në portale të ndryshme. Kështu, fillimisht, viktimja I. M. ka pretenduar se është kërcënuar nga një person që unë e paskam gjykuar para disa vitesh. Po kështu, në këtë shkrim (në portalin e parë), viktimja më ka sulmuar mua personalisht sikur kam paragjykuar këtë çështje.

Në ditët në vijim, në një portal tjetër viktimja avancon duke pretenduar një tjetër variant sikur shtetasi që e kërcënon (dhe që e kam gjykuar unë disa vite më parë) ka lidhje me faktin penal që gjykohej F. S., fakt të cilin nuk e ka pretenduar në asnjë fazë të këtij procedimi që ka filluar para shumë vitesh.

Në seancën gjyqësore të datës 5.10.2020 viktimja I. M. u qëndroi këtyre pretendimeve të pabazuara e të paprovuara, por të pretenduara prej tij si të vërteta. Pavarësisht se pretendimet e kërkuarit ishin absolutisht të pavërteta, por unë kam dhënë dorëheqjen për të garantuar viktimën I. M. për një gjykim të paanshëm, si dhe për të garantuar të pandehurin për një gjykim nga një gjykatë jashtë presioneve, ndaj kam të njëjtin qëndrim që kam mbajtur në kërkesën për heqje dorë (kërkesë të cilën ju e dispononi). Seanca e vetme gjyqësore që është zhvilluar ka qenë ajo e datës 5.10.2020 dhe ky ka qenë momenti i vetëm procedural ku unë mund të jepja dorëheqjen sepse siç ju shpjegova më lart, të gjitha shkrimet janë bërë në harkun kohor të dy seancave gjyqësore.”

29.5 Nga disa informacione mediatike⁶² duket sikur subjektit i është refuzuar viza amerikane.

29.5.1 Në vijim, Komisioni i ka kërkuar informacion DSİK-së, nga ku deri në këtë moment nuk kanë rezultuar që këto *indicie* të jenë të vërteta.

29.6 Komisioni, nga informacione mediatike, është informuar lidhur me vendimin nr. *** i regj. themeltar: nr. *** i vendimit (***), të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Nga ky vendim vihet re se gjyqtari Shkëlqim Mustafa ka firmosur në dispozitivin e vendimit të trupit gjykues për një çështje të gjykuar në Gjykatën e Apelit Tiranë, ndërkohë që nuk ka qenë në përbërje të këtij trupi gjykues gjatë vendimmarrjes së tij. Konkretisht, vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë citon: “Në këto rrethana, vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë është marrë në shkelje të dispozitës së nenit 15/1 të Kodit të Procedurës Penale, çka në detyrim të dispozitës së nenit 128 /1-a të Kodit të Procedurës Penale e bën vendimin e saj absolutisht të pavlefshëm, për shkak se gjyqtari Sh. Mustafaj nuk ka pasur kushtet për të qenë gjyqtar në gjykimin e kësaj çështjeje. Sipas dispozitës së nenit 15/1 të Kodit të Procedurës Penale, gjyqtari që ka dhënë ose që ka marrë pjesë në dhënien e vendimit në një shkallë të procedimit nuk mund të ushtrojë funksionet e gjyqtarit në shkallët e tjera, as të marrë pjesë në rigjykim pas prishjes së vendimit ...”.

29.6.1 Komisioni i ka kërkuar Gjykatës së Apelit Tiranë informacion⁶³ në lidhje me çështjen penale të përfunduar pranë saj me vendimin nr. ***, datë 7.3.2014, që i përket kërkuarit R. R.. Gjykata e Apelit Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 5.10.2020, ka vënë në dispozicion informacionin e kërkuar nga verifikimi i të cilit rezultoi se:

⁶² <https://360grade.al/288946/nga-pasuria-enigmatike-tek-lista-e-zeze-e-shba-dritehijet-e-gjyqtarit-te-apelit/>

⁶³ Shkresë nr. *** prot., datë 1.10.2020.

- Në datën 7.3.2014, me vendim nr. ***, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur lënie në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke mospranuar ankimin e kërkuetit R. R.. Vendimi rezulton të jetë firmosur nga treshja e gjyqtarëve ku në përbërje është edhe subjekti i rivlerësimit.
- Në procesverbalin e datës 28.2.2014 rezulton se subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kërkesën për heqje dorë nga gjykimi i kësaj çështjeje, pasi është shprehur për këtë çështje me vendimin nr. *** akti, datë 7.12.2010.

Për sa më sipër duket se subjekti ka nënshkruar një vendim në të cilin nuk ka qenë pjesë e trupës gjykuese, për sa kohë ka dhënë dorëheqje nga gjykimi dhe është zëvendësuar nga një gjyqtar tjetër.

29.6.2 Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të shpjegojë mbi faktet e rezultuara më lart në raport me legjislacionin në fuqi, lidhur me tagrin në firmosjen e vendimit në raport me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.

29.6.3 Subjekti shpjegon: *“Në lidhje me këtë çështje ju sqaroj se unë kam hequr dorë nga gjykimi i çështjes penale me kërkuet R. R. dhe në vendin tim është caktuar një gjyqtar tjetër. Që në momentin që kam dhënë dorëheqjen unë nuk jam futur në këtë gjykim dhe çështja ka përfunduar me tre gjyqtarë të tjerë, siç rezulton dhe nga procesverbali i seancës dhe gjykata ka disponuar me vendimin nr. ***, datë 7.3.2014.*

Pasi është arsyetuar vendimi, gabimisht, në vendim në trupin gjykues është shënuar emri im. Sekretarja gjyqësore ma ka sjellë mua për firmë. Nisur nga ngarkesa e madhe e punës në, si praktikë, firmosim shumë vendime dhe procesverbale gjatë një dite pune dhe meqë unë kam parë emrin tim, në nxitim e sipër e kam nënshkruar. Pra, unë nuk kam gjykuar këtë çështje, por nga pakujdesia kam nënshkruar në vendim, ku gabimisht ishte shkruar emri im”.

29.7 Nga disa *indicie* të mbledhura nga Komisioni, Gjykatës së Apelit Tiranë⁶⁴ i është kërkuar për verifikim dosja penale me palë të pandehur shtetasin G. M. e shqyrtuar nga gjyqtari Shkëlqim Mustafa.

Nga materiali në dosje rezulton se shtetasi G. M. është dënuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me dy vjet burgim, për veprën penale “mbajtje pa leje të armëve” dhe “drejtimi i automjetit në gjendje të dehur”. Gjatë gjykimit në Gjykatën e Apelit Tiranë, mbështetur në kërkesën e bërë nga shetasi G. M. (avokati i tij), ai është liruar në sallën e gjyqit për shkak të një interpretimi që trupi gjykues ka bërë lidhur me aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal.

Nga vlerësimi i dokumentacionit në dosje duket se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është i drejtë dhe duhej lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë, duke mos pranuar aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal dhe duke pezulluar ekzekutimin e vendimit të dënimit me burgim.

Pas verifikimit duket se ky shtetas është liruar në sallën e gjyqit dhe është larguar të nesërmen drejt Italisë.

29.7.1 Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit lidhur me qëndrimin e mbajtur prej tij në këtë çështje penale.

29.7.2 Subjekti shpjegon: *“Në çështjen ndaj të pandehurit G. M. Gjykata e Apelit Tiranë ka aplikuar dënimin alternativ të pezullimit të ekzekutimit të pjesës së mbetur të dënimit me burgim sipas parashikimeve të nenit 59 të Kodit Penal. Ju përshkruan faktin që i dënuari është larguar në Itali, por Gjykata e Apelit Tiranë, në këtë rast, nuk ka aplikuar dënimin alternativ ‘Qëndrimi në shtëpi’ sipas nenit 59/a të Kodit Penal.*

Gjykata e Apelit Tiranë ka disponuar me pezullimin e ekzekutimit të pjesës së mbetur të dënimit me burgim për të pandehurin G. M., për një periudhë prove prej 2 vjetësh për shkak se plotësosheshin kushtet ligjore. Është evidentuar shkalla jo e lartë e rrezikshmërisë shoqërore e të pandehurit, gjendja e tij familjare, gjendja shendetësore, si dhe fakti që ai kishte kryer 2/3 e dënimit të dhënë.

Fakti se i pandehuri është larguar ditën e nesërme drejt Italisë nuk tregon se mungonin kushtet për aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal. Siç theksova më lart, në këtë rast nuk është aplikuar dënimi alternativ ‘Qëndrimi në shtëpi’. Por, ekzekutimi i dënimeve alternative nuk është kompetencë dhe as përgjegjësi e gjykatës, por ndiqen nga Prokurori dhe Shërbimi i Provës. Në

⁶⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 2.10.2020.

momentin e gjykimit kanë qenë evidente të gjitha kushtet ligjore për aplikimin e pezullimit të ekzekutimit të pjesës së mbetur të dënimit me burgim për të pandehurin G. M.”.

30. Në përfundim, trupi gjykues i Komisionit, pasi vlerësoi denoncimet e ardhura në Komision, si dhe ato të mbledhura nga burime të tjera, në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, nuk gjeti prova e fakte të cilat të ngrenë dyshime të arsyeshme mbi veprime korruptive të kryera nga subjekti i rivlerësimit apo në bashkëpunim me persona të tjerë. Të vlerësuara në kuadër të vlerësimit profesional të subjektit gjykohej se ato nuk cenonë nivelin minimal kualifikues të kërkuar nga ligji.

31. Konkluzione për rubrikën e vlerësimit profesional

Trupi gjykues vlerëson se në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të mira në punë, ka respektuar të drejtat e palëve dhe konsiderohet “i aftë”.

Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit e ka nivelin minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 2, të nenit 4 dhe germës “c”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti nuk ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Shkëlqim Mustafa, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë.
2. Ky vendim, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, më 13.1.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Roland ILIA
Kryesues

Valbona SANXHAKTARI
Relatore

Genta Tafa (BUNGO)
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Orjanda Liçi

* * Korigjuar me vendimin nr.333/1, datë 3 mars 2021, “Për korigjim gabimi”.